



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 54 regjistër (JR)  
Datë 14.11.2023

Nr. 21 i vendimit  
Datë 27.02.2026

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 27.02.2026, ora 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 54/2023 (JR), datë 14.11.2023, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 698, datë 15.09.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, i cili përfundimisht bazuar në nenet 4, pika 2, 61, pikat 4 dhe 5, si dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 698, datë 15.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor<sup>1</sup>, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë<sup>2</sup>, deklaratën për kontrollin e figurës<sup>3</sup>, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional<sup>4</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishtëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.
  - (ii) Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
  - (iii) Ka kryer fshehje të pasurive.
  - (iv) Ka kryer deklarim të rremë.

<sup>1</sup> Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>2</sup> Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 29.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.01.2017.

<sup>3</sup> Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 26.01.2017.

<sup>4</sup> Dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme më datë 26.01.2017, sipas referimit në “Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016” të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. {\*\*\*} prot., datë 08.07.2020.

(v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Në vijim, në raportin e rishikuar mbi kontrollin e figurës me kërkesë të Komisionit, DSIK-ja ka konfirmuar konstatimin fillestar për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Gjergji P. Tako.
5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).
7. Komisioni, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit të kryer në seancën dëgjimore publike të zhvilluar më datë 15.06.2022, me Vendimin e Ndërmjetëm nr. {\*\*\*}, (nr. {\*\*\*} Akti), datë 17.06.2022, vendosi pezullimin nga detyra të z. Gjergji Tako për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për të tri kriteret e rivlerësimit, në përfundim të këtij trajnimi dhe pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti i rivlerësimit.
8. Shkolla e Magjistraturës, me anë të shkresës nr. {\*\*\*}prot., datë 21.07.2023, njoftoi Komisionin se sipas vendimit të ndërmjetëm nr. {\*\*\*} (me nr. akti {\*\*\*}), datë 17.06.2022, të Komisionit ku është vendosur pezullimi nga detyra i z. Gjergji Tako për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin e tij për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, kjo e fundit ka miratuar planin dhe programin mësimor për subjektet e rivlerësimit me vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës. Në këtë shkresë thuhet se: *Subjektet kanë ndjekur rregullisht mësimin duke filluar nga data 3 tetor 2022 deri në përfundim të tij datë 19 maj 2023. [...] Në përfundim të procesit mësimor [...] z. Tako ka zhvilluar provimin përfundimtar, i cili u krye sipas parashikimeve në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, ku në nenin 45/1 të saj ka përcaktuar se: “Në kuptim të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjektet e rivlerësimit të cilët janë*

pezulluar nga detyra dhe kanë detyrimin të ndjekin programin njëvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në përfundim të vitit të parë akademik vlerësohen nga rezultatet e provimit përfundimtar, i cili do të përfshijë rezultatit e vlerësimeve në lëndët të cilat do të zhvillohen gjatë vitit të parë teorik (60% të vlerësimit të përgjithshëm) dhe një provimi me raste praktike (40% të vlerësimit të përgjithshëm), të cilat do të jenë në funksion të drejtimit të tij dhe mangësive të shprehura me vendim nga institucionet e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit do të zhvillojë provimin me rastet praktike vetëm në rast se arrin të marrë një vlerësim të paktën “mjaftueshëm” në provimin e secilës lëndë. [...] Z. Tako mori gjithsej 90.07 pikë, të cilat janë 90.07%, sipas vlerësimit me shkallë vlerësohet me nivelin “Shumë mirë”. [...] Këto rezultate u miratuan në Këshillin Pedagogjik, e më pas në Këshillin Drejtues, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.07.2023, i cili miratoi vlerësimin përfundimtar për subjektet e rivlerësimit [...] z. Gjergji Tako, duke arritur në përfundimin se subjektet e rivlerësimit kanë arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe përcjelljen e tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

9. Komisioni në vijim, më datë 15.09.2023, përfundoi procesin e rivlerësimit për subjektin Gjergji Tako duke marrë vendimin nr. 698 datë 15.09.2023.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

10. Komisioni, me vendimin nr. 698, datë 15.09.2023, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë [...]”.
11. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 59, pika 1 dhe 60 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

**11.1** Në lidhje me vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se pavarësisht se përdorimi i automjeteve pa leje qarkullimi përbën veprim në kundërshtim me etikën e prokurorit, duke marrë në konsideratë faktin se nga hetimi administrativ i pasurisë rezulton se subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako ndodhet në kushtet e deklarimit të saktë dhe me burime të ligjshme, duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlerëson se ky fakt nuk përbën shkak për shkarkim nga detyra, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

**11.2** Në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (ii) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (iii) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

**11.3** Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, pas analizimit të detajuar të dosjeve të administruara qoftë në kuadrin e vlerësimit profesional, qoftë në kuadrin e vlerësimit të figurës, Komisioni konstatoi

*mangësi profesionale, të cilat mund të plotësoheshin nëpërmjet ndjekjes së programit të trajnimit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës. Me vendimin nr. {\*\*\*} akti, datë 17.6.2022, trupi gjykues vendosi pezullimin nga detyra të z. Gjergji Tako për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Në përfundim të këtij trajnimi, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.7.2023, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar në Komision rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit, bazuar në pikën 2 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.7.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Gjergji Tako, ka arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në përfundim, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

### **III. Shkaqet e ankimit**

12. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 02.11.2023, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 698, datë 15.09.2023, për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako me pretendimin se ky vendim përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
13. Komisioneri Publik pretendoi se në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, si dhe propësimeve të subjektit, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, subjekti i rivlerësimit nuk e ka kaluar nivelin kualifikues në kontrollin e aftësisë profesionale për konfirmimin e tij në detyrë dhe se me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke u gjendur në kushtet që mangësitë e evidentuara nuk mund të plotësohen, as nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, siç ka vendosur me vendim të ndërmjetëm Komisioni. Komisioneri Publik vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, një nga rastet e parashikuara për shkarkimin nga detyra.
14. Komisioneri Publik kundërshtoi edhe konkluzionin e Komisionit lidhur me automjetin e markës “Mercedes Benz”, me targë origjine {\*\*\*}, si të bazuar në një vlerësim jo të drejtë të rrethanave të përdorimit tij nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu ai pretendoi se gjetjet e Komisionit gjatë hetimit administrativ edhe mbi 2 automjetet e tjera, automjetin e markës “Mercedes Benz”<sup>5</sup> dhe autoveturën e markës “Volkswagen MH2 Golf”<sup>6</sup>, që përfaqësojnë mënyrën e të vepruarit të subjektit të rivlerësimit jashtë aktivitetit profesional, të vlerësuara së bashku me shkeljet e lejuara gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, problematikat e përsëritura e të kthyera në një model pune gjatë viteve të ushtrimit të detyrës, ndikimi në veprimtarinë shtetërore i aktivitetit profesional të subjektit të rivlerësimit, parë kjo në kuadër të rëndësisë së perceptimit publik përgjatë ushtrimit të detyrës së magjistratit, në vlerësimin tërësor të procedurave në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr.

<sup>5</sup> Me targë të huaj {\*\*\*} e në vijim me targë {\*\*\*}.

<sup>6</sup> Me numër shasie {\*\*\*}.

84/2016, në tërësi kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për këto shkaqe, subjekti i rivlerësimit duhet të konsiderohet i papërshtatshëm për vijueshmërinë e detyrës, edhe në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

15. Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi marrjen në shqyrtim nga Kolegji të shkaqeve të paraqitura në ankim dhe në përfundim të gjyqimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

° *Ndryshimin e vendimit nr. 698, datë 15.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako.*

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

*A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit*

*a) Juridiksioni i Kolegjit*

16. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi përfundimtar të Komisionit<sup>7</sup>, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Legjitimimi i Komisionerit Publik si ankues*

17. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>8</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

18. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi kundër vendimit të Komisionit i ushtruar nga Komisioneri Publik, shqyrtohet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt

<sup>7</sup> Referoju paragrafëve 10-12 në vendimin e Kolegjit (JR) nr. 61/2025.

<sup>8</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 698, datë 15.09.2023, për rivlerësimin e subjektit Gjergji Tako, i është njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 18.10.2023, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., të së njëjtës datë, kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit më datë 02.11.2023, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2023, që rezulton të jetë dita e 15-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve në datat 15.12.2025, 26.01.2026, 03.02.2026 dhe 27.02.2026.

19. Trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës<sup>9</sup> dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore të datës 15.12.2025, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili u përfaqësua në këtë gjykim nga z. Klodjan Braho, prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas autorizimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nr. {\*\*\*} prot., datë 10.12.2025.
20. Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar trupit gjykues gjatë seancës së datës 15.12.2025, për çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin si provë shkresore të akteve të depozituara gjatë parashtrimeve në Kolegj, si dhe qëndrimin të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se lidhur me denoncimin e shtetasit A.L.<sup>10</sup> ekzistojnë shkaqe për hetime të mëtejshme, duke kërkuar nga Kolegji çeljen e hetimit me qëllim verifikimin e zbatimit të procedurave dhe detyrimeve procedurale lidhur me njoftimin e përfundimit të hetimeve në çështjen penale me të pandehur denoncuesin A.L., trupi gjykues, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45 e 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vendosi:
  - Të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës të gjitha aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit krahas parashtrimeve të paraqitura në Kolegj.
  - Të çelë hetimin gjyqësor për denoncimin e shtetasit A. L. duke kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë aktet procedurale që lidhen me procedimin penal nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*} të vitit 2021, të Prokurorisë së Shkallës së Parë të juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Trupi gjykues vendosi të mos çelë hetimin gjyqësor për denoncimet e tjera të publikut të depozituara në Kolegj, pasi ato nuk plotësojnë kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.
21. Trupi gjykues në seancën gjyqësore të datës 03.02.2026, në kuadër të çeljes së hetimit gjyqësor lidhur me denoncimin e shtetasit A.L., me vendim të ndërmjetëm, vendosi të pranojë dhe të marrë në cilësinë e provës aktet procedurale që i përkasin procedimeve penale me nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*} të vitit 2021, të përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Trupi gjykues mori në cilësinë e provës edhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit që shoqërojnë vendimin për pezullimin e hetimeve të datës 20.04.2022 të marrë nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të materialeve shtesë të përcjella nga denoncuesi A. L.

---

<sup>9</sup> Referuar parashikimit të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, me mbarimin e mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

<sup>10</sup> Protokolluar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2025.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

22. *Lidhur me shkakun e ankimit për vlerësim të gabuar nga Komisioni të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.*
23. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion Komisioni e ka arritur pasi subjekti i rivlerësimit ka përfunduar me rezultate të kënaqshme trajnimin pranë Shkollës së Magjistraturës, në zbatim të Vendimit të Ndërmjetëm të Komisionit nr. {\*\*\*} (me nr. akti {\*\*\*}), datë 17.06.2022, për pezullimin e subjektit nga detyra dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit bazuar në parashikimet e nenit E, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 60, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
24. Komisioneri Publik, në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm, pretendoi se në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk e ka kaluar nivelin kualifikues në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për konfirmimin e tij në detyrë dhe se, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke u gjendur në kushtet që mangësitë e evidentuara nuk mund të plotësohen as nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Komisioneri Publik pretendoi se veprimtaria profesionale e subjektit të rivlerësimit, e materializuar në veprimet dhe mosveprimet e tij vijuese në shkelje të detyrimeve ligjore, është e shoqëruar dhe vjen si pasojë e njohurive, aftësive, gjykimeve dhe qëndrimeve të tilla që përfaqësojnë haptazi një model të vepruarit aq të dobët, sa kurrsesi nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe se mangësitë e thella e të rëndësishme të verifikuara nuk mund të korrigjoheshin përmes programit njëvjeçar të edukimit, e për pasojë, duhet të zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit, sipas nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës.
25. Trupi gjykues vëren se në analizën e tij lidhur me argumentimin e shkakut të ngritur në ankim për mosarritjen e një niveli kualifikues në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale Komisioneri Publik ka evidentuar në ankim të gjitha gjetjet e Komisionit të evidentuara në vendimin e ndërmjetëm të këtij të fundit, nr. {\*\*\*} (me nr. akti {\*\*\*}), datë 17.06.2022, por ndryshe nga ky i fundit të cilat këto gjetje i ka vlerësuar si mangësi profesionale për të cilat zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit, bazuar në nenin E, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, Komisioneri Publik pretendoi se ato janë dëshmi e faktit se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësitë e vërejtura nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit dhe për të cilën, në zbatim të nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, duhet të zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sipas tij, subjekti i rivlerësimit, në asnjë rast, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe, për pasojë, duhet të konsiderohet si “i papërshtatshëm” për të ushtruar funksionin e prokurorit, sipas parashikimit të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë Komisioneri Publik

pretendoj se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, situatë për të cilën parashikohet shkarkimi nga detyra.

26. Në parashtrimet e tij lidhur me ankimin, përpara Kolegjit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme deklaroi se u qëndron *në parim* shkaqeve të ankimit të ushtruar në datën 02.11.2023 nga Komisioneri Publik kundër vendimit të Komisionit nr. 698, datë 15.09.2023.
27. Ndërkohë subjekti i rivlerësimit prapësoi se konkluzioni i ankuesit se subjekti rezultoi “i papërshtatshëm për vijueshmërinë e detyrës” nuk qëndron, pasi nuk mbështetet as në efektin real të sjelljes profesionale as në një vlerësim proporcional dhe të individualizuar, siç kërkon vetë ligji. Sipas subjektit të rivlerësimit argumenti i Komisionerit Publik, i ndërtuar mbi supozimin se disa gjetje të agreguara përbëjnë “model pune” apo “përsëritje të problematikave”, duhet testuar ndaj provës objektive të dosjeve të administruara. Çdo konkluzion për cenim të besimit të publikut nuk mund të qëndrojë mbi nocione të përgjithshme, mbi etiketime zero faktike, apo mbi interpretime të shkëputura nga kufijtë e kompetencave ligjore të prokurorit të kohës. Përkundrazi, kërkohet që analiza të evidentojë nëse në praktikë ka pasur çrregullime që kanë prodhuar pasoja reale mbi të drejtat e palëve, mbi integritetin e procedurës apo mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë.
28. Në fazën e bisedimeve përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme shpjegoi se nga shqyrtimi i prapësimeve të subjektit të rivlerësimit dhe aktet e paraqitura dhe të administruara në cilësinë e provave gjatë gjyqimit në Kolegj, qëndrimi i tij sipas vlerësimit të çështjeve penale në të cilat bazohet shkaku i ankimit objekt shqyrtimi është i ndarë në dy kategori.
29. Për kategorinë e parë të përbërë prej 12 çështjesh penale të marra në shqyrtim, konkretisht: vendim për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, viti 2014; vendim për pushimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2014, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal; vendim për pushimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2015, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal; kërkesë për gjykimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2018, për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal; vendim për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, viti 2014, për veprën penale “Ndërtim pa leje”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal; kërkesë për gjykimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2014, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal; vendim për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, viti 2015, për veprën penale “Dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal; vendim për pushimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2016, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal; kërkesë për gjykimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2013, për veprën penale “Dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal; kërkesë për gjykimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2015, për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal; vendim për pushimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2016, për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal; vendim për pushimin

e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, të vitit 2016, për veprën penale “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal - nuk janë gjetur shkelje procedurale të tilla që mund të sjellin masë disiplinore, për rrjedhojë shkaku i ankimit për secilën prej këtyre çështjeve sipas ankuesit u vlerësua i shëruar. Këtë përfundim Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme shprehet se e ka arritur duke pasur parasysh shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e administruara në gjykim, si dhe se: (i) mangësitë e konstatuara lidhen me mungesën e analizës ligjore për elementet e kërkuara për të konfiguruar veprën penale në disa prej këtyre çështjeve; (ii) veprimet hetimore janë ndërmarrë brenda kuadrit të procedurës dhe janë administruar aktet respektive; (iii) hallka e kontrollit gjyqësor ndaj vendimeve të subjektit të rivlerësimit i ka gjetur të bazuara kërkimet e tij në cilësinë e prokurorit të çështjes.

30. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues, në konsideratë edhe të parashikimeve të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësoi të mos i marrë në analizë këto çështje penale, duke mbetur për rrjedhojë i pacenuar vlerësimi përfundimtar i Komisionit në raport me këto çështje.

31. Sa i përket kategorisë tjetër të çështjeve penale, për të cilat Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pretendoi se mangësitë e konstatuara nuk lidhen me mungesën e njohurive ligjore dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit por me angazhimin dhe përgjegjshmërinë e tij në funksion në një shkallë të tillë që tregojnë një model pune i cili nuk mund të korrigjohej përmes programit njëvjeçar të edukimit pranë Shkollës së Magjistraturës, dhe që mund të shërbejë si bazë për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, trupi gjykues çmoi t’i marrë ato në analizë duke i grupuar sipas pretendimeve të ankuesit, nga analiza e të cilave konstatoi si më poshtë.

➤ Lidhur me çështjet penale për të cilat ankuesi pretendoi se mangësitë e konstatuara kanë të bëjnë me mungesën e analizës ligjore për elementet e kërkuara për të konfiguruar veprën penale.

▪ Sa i takon kërkesës për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, për veprat penale “Kanosja për shkak të detyrës” dhe “Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 238 dhe 305/b të Kodit Penal (pika 15 e ankimit), trupi gjykues vëren se:

32. Lidhur me kërkesën për dërgimin për gjykim të këtij procedimi penal, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar për kualifikimin ligjor të veprës penale dhe sipas kontrollit të bërë nga gjykata është gjetur si i gabuar cilësimi juridik nga prokurori. Në mbështetje të këtij pretendimi ai ka parashtruar se në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 26.04.2017, të lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, citohet: [...] çështja penale objekt gjykimi ndaj të pandehurit L.P. për akuzën e kryerjes së veprës penale të kanosjes për shkak të detyrës të parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal [...] duhet të pushohet për shkak se për sa u argumentua e arsyetua më sipër kualifikimi ligjor që akuza i ka bërë faktit është i gabuar.

33. Në kundërshtim të këtij shkakut ankimi subjektit prapësoi në Kolegj ndër të tjera<sup>11</sup> se pretendimi për moskryerje të “analizës së elementeve të figurës së veprës penale” nuk është i mbështetur në ligj, pasi sipas tij neni 331 i Kodit të Procedurës Penale në përmbajtjen e tij në vitin 2014 nuk kërkon në asnjë nga pikat e tij analizë doktrinare të elementeve të veprës penale, detyrim ky i cili sipas subjektit të rivlerësimit lind vetëm kur çështja paraqet vështirësi interpretimi. Sipas tij kjo vërtetohet me përmbajtjen në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale i cili urdhëron tregimin e neneve të Kodit Penal, urdhërim të cilin subjekti pretendoi se e ka zbatuar. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vendimin e saj nr. {\*\*\*}, datë 26.04.2017, të cilin subjekti e ka paraqitur në cilësinë e provës së re, ka evidentuar se në aktet e Prokurorisë gjendet i përcaktuar kualifikimi ligjor i veprës penale. Sipas subjektit të rivlerësimit në të gjithë përmbajtjen e vendimit gjykata nuk ka shprehur asnjë rezervë për cilësinë/qartësinë/kuptueshmërinë e kërkesës për gjykim, apo të akteve të tjera të prokurorit.
34. Gjithashtu, sipas tij, procesverbalet e seancave të këtij gjykimi të paraqitura në cilësinë e provave të reja në procesin para Kolegjit nuk evidentojnë në asnjë rast kundërshti apo paqartësi ndaj akteve të prokurorit. Sipas subjektit kërkesa e mbrojtësit i ri për të pandehurin L. P. gjatë seancës së datës 28.03.2017, për gjykim të shkurtuar, tregon se kjo palë i pranon ashtu sikurse janë aktet e prokurorit, pa vërejtje, pra edhe kërkesën për gjykim. Subjekti i rivlerësimit prapësoi pretendimin e Komisionerit Publik në ankim sipas të cilit ai vetë (subjekti) të ketë treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në treguesit e analizës, neni 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, ku arsytimi ligjor është një nga dy komponentët e vlerësimit profesional. Sipas subjektit të rivlerësimit edhe nëse Kolegji do të gjejë mangësi formale në arsytimin ligjor në dosjen konkrete, dhe në tërësi, këto mangësi sipas përcaktimeve të nenit 44, shkronja “b” përfshihen plotësisht në kategorinë e mangësive të korrigjueshme, dhe nuk përmbushin kriteret ligjore për t’u kualifikuar si të pakorrigjueshme.
35. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti theksoi se ka kryer programin 1-vjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, në të cilin, për këtë qëllim, është miratuar edhe kurrikula e disiplinës “Shkrim dhe arsytim ligjor” me përmbajtje si treguar nga subjekti në parashtrimet e tij<sup>12</sup>. Në përfundim, subjekti parashtrroi se në periudhën 2-vjeçare të ushtrimit të detyrës pas përfundimit të programit pranë Shkollës së Magjistraturës ka hartuar një sërë aktesh procedurale (kërkesa për gjykim, kërkesa për pushim, vendime mosfillimi dhe vendime pushimi) të cilat i ka paraqitur si provë në Kolegj në mbështetje të pretendimit të tij për rritje të cilësisë dhe qartësisë së akteve në kuadër të aftësisë së tij vetëkorrigjuese.
36. Lidhur me këtë akt procedural “*kërkesë për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2014*, i cili rezultoi të jetë një nga 3 aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit për vlerësimin e këtij kriteri sipas parashikimeve të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues pasi shqyrtoi aktet e

---

<sup>11</sup> Në kushtet kur një pjesë e pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim është vlerësuar e shëruar gjatë gjykimit në Kolegj, prapësimet e subjektit do të referohen vetëm në raport me atë pjesë të pretendimeve të rikonfirmuara nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në fazën e bisedimeve përfundimtare.

<sup>12</sup> Shih faqen 10 të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit të dorëzuara në Kolegj.

fashikullit të Komisionit, referuar edhe sa konstatuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe në vijim nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, vëren se subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka përpiluar kërkesën për gjykim për çështjen penale nr. {\*\*\*} të vitit 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kundër të pandehurve L. (K.) P., i akuzuar për veprën penale “Kanosje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal dhe A. H., i akuzuar për veprën penale “Deklarim i rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal, në kuadër të trajtimit të kallëzimit penal të shtetasit T. B., Deputet në Kuvendin e Shqipërisë, të paraqitur më datë 12.05.2014, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë<sup>13</sup>. Nga shqyrtimi i kësaj kërkesë trupi gjykues konstatoi se pretendimi i ankuesit se subjekti i rivlerësimit nuk kishte arsyetuar lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale u gjet i bazuar. Në paraqitjen e kësaj kërkesë për gjykim, trupi gjykues vuri re se subjekti i rivlerësimit vlerësimin e tij për kualifikimin e faktit të parashtruar në pjesën përshkruese të aktit, në veprat penale të sipërcituara, e kishte realizuar pa kryer një analizë mbi elementet e këtyre dy veprave penale dhe, po ashtu, pa paraqitur arsyet se përse faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë hetimit të kryer, sipas tij kualifikoheshin sipas veprave penale “Kanosje për shkak të detyrës” dhe “Deklarim i rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 238 dhe 305/b të Kodit Penal. Trupi gjykues çmoi me rëndësi të evidentojë se në kërkesat për gjykim të përpiluara nga prokurori, në zbatim të parashikimeve të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, pasqyrimi i analizës mbi elementet e veprave penale për të cilat akuzohen të pandehurit paraqet rëndësi të veçantë në kuadër të garantimit të një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të realizimit të një mbrojtje efektive nga të pandehurit në kundërshtimin e kualifikimit ligjor të faktit penal nga organi i akuzës, nëpërmjet argumenteve dhe provave.

37. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se edhe pretendimi tjetër i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se nga kontrolli i bërë nga gjykata është gjetur si i gabuar cilësimi juridik i bërë nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes, rezultoi i bazuar, pasi nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes u konstatua se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj nr. {\*\*\*}, datë 26.04.2017, kishte ndryshuar cilësimin juridik të faktit penal nga “Kanosje për shkak të detyrës” në “Fyerje të të dëmtuarit” dhe, në përfundim, për pasojë ka pushuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit L. K. P. për kryerjen e veprës penale “Kanosje për shkak të detyrës” të parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit.
38. Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të palëve lidhur me aktin procedural “Kërkesë për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014”, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aftësinë e tij profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, sa i takon aspektit të arsyetimit ligjor vlerësuar në raport me indikatorin e cilësisë së analizës së akteve të përgatitura prej tij.

---

<sup>13</sup> Për më shumë detaje rreth rrethanave të faktit, referojuni raportit të përgatitur nga KLP-ja në faqen 7 e në vijim, si dhe rezultateve të hetimit administrativ të përgatitur nga Komisioni në faqen 78 e në vijim.

▪ *Lidhur me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2013, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 283/1 dhe 278, pikat 2 dhe 3 të Kodit Penal.*

39. Lidhur me kërkesën për gjykimin e këtij procedimi penal, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka pretenduar se, pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka mbetur si mangësi e pashëruar nga shkaqet e ngritura në ankim, fakti që kërkesa për gjykimin e këtij procedimi penal nuk ka analizë për parashtrimin e faktit penal sipas dispozitave materiale penale për veprat penale, për të cilat është ngritur akuza, si dhe se, kërkesa nuk përmban analizën e individualizimit të përgjegjësisë penale për secilin të pandehur.
40. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij para Kolegjit lidhur me shkakun e ankimit të ngritur në lidhje me këtë çështje penale në prapësimet e tij ndaj ankimit është fokusuar në mënyrë të veçantë në pretendimet e tjera<sup>14</sup>, të cilat, sipas qëndrimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në fazën e bisedimeve përfundimtare, u vlerësuan të shëruara. Sa i përket çështjes së mungesës së analizës së elementeve të figurës së veprës penale dhe individualizimit të përgjegjësisë penale, subjekti ka prapësuar në mënyrë të përgjithshme se të gjitha aktet në dosje janë konfirmuar me nënshkrim nga zëvendësdrejtuesi dhe drejtuesi i prokurorisë së kohës, të cilët kishin kompetencë të plotë vendimmarrëse dhe shfuqizuese. Sipas tij, mungesa totale e çdo vërejtjeje apo shënimi korrigjues nga ana e tyre, është tregues i qartë se dosja ka qenë brenda standardeve më të mira procedurale të kohës. Sipas subjektit, për sa kohë nga kjo çështje penale nuk ka rrjedhur asnjë pasojë serioze, nuk ka pafajësi, nuk ka burgim të padrejtë, nuk ka shpenzim publik të padrejtë, nuk ka lehtësim të papranueshëm të pozitave të të pandehurve, kjo konfirmon faktin se hetimi ka qenë i rregullt, i ligjshëm dhe në funksion të drejtësisë materiale. Si rrjedhojë, subjekti pretendoi se nuk ekziston asnjë element që të tregojë cenim të besimit të publikut sepse drejtësia është dhënë pa pasoja dhe në përputhje të plotë me ligjin dhe me standardin e kohës.
41. Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi të ankuesit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi fillimisht se ky procedim penal është një nga 5 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësimin e këtij kriteri, sipas parashikimeve të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016. Nga analizimi i akteve të këtij fashikulli penal, rezultoi se në përfundim të hetimeve lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 18.11.2013, është përgatitur nga prokurori Gjergji Tako kërkesa për gjykimin e çështjes drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të të pandehurve B. Q. për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të parashikuar nga neni 283, paragrafi 1 i Kodit Penal dhe K. Q. (i vëllai) për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake ose municioneve”, parashikuar nga neni 278, paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Penal. Këta shtetas rezultojnë të jenë arrestuar në flagrancë, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale

<sup>14</sup> Komisioneri Publik në ankim lidhur me këtë procedim penal kishte ngritur pretendime edhe lidhur me: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka përfshirë në dokumentin e njoftimit të akuzës së të pandehurit datë 10.02.2014, akuzën për veprën penale “Mbajtje pa leje të municioneve luftarake”, sipas referimit të policisë; (ii) akti “Për plotësimin e akuzës” datë 07.03.2014, ndaj shtetasit B. Q. për veprën penale “Mbajtje pa leje të municioneve luftarake” të parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal, është hartuar pa kryer veprime hetimore shtesë; (iii) [...].

të parashikuara nga nenet 283, paragrafi 2 (“Prodhim dhe shitje të narkotikëve kryer në bashkëpunim”) dhe 278, paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Penal, duke qenë se gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit F. T., në përdorim në atë kohë të vëllezërve B. dhe K. Q. në fshatin {\*\*\*} të Komunës Shëngjergj, është gjetur një sasi lëndësh narkotike dhe municionesh luftarake. Sipas akteve, rezultoi se sasia e lëndës së sekuestruar e llojit *cannabis sativa*, pas peshimit, ka rezultuar në masën e 236 kg dhe 51 gramë së bashku me ambalazhin, gjithashtu është gjetur një armë zjarri automatike, 324 copë fishekë të kalibrit 7,62 mm, 9 copë kallëpe dinamiti, një fitil detonator dhe një paruke. Në datën 18.11.2013, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për *regjistrimin e procedimit penal për nenet 283/2 dhe 278/2/3 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasve Bujar dhe K. Q.*

42. Trupi gjykues konstatoi se si pretenduar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, kërkesa për gjykimin e çështjes drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk paraqet ndonjë analizë të parashtrimit të faktit penal sipas dispozitave materiale penale, për veprat penale për të cilat është ngritur akuza, si dhe se nuk ka një analizë të mirëfilltë të individualizimit të përgjegjësisë penale të secilit të pandehur. Gjithashtu, trupi gjykues konstatoi gjithashtu se nga shqyrtimi i përmbajtjes së akteve që shoqërojnë kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim<sup>15</sup> dy të pandehurit janë hetuar fillimisht për konsumim të veprave penale të parashikuara nga neni 283, paragrafi 2, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” e kryer në bashkëpunim dhe neni 278, paragrafët 2 dhe 3, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe municioneve”, ndërsa në përfundim të hetimit janë dërguar për gjykim për përgjegjësi penale të individualizuar përkatësisht K. Q., sipas parashikimeve të nenit 283, paragrafi 1, dhe B. Q., sipas parashikimeve të nenit 278, paragrafët 2 dhe 3, por në mungesë të një analize të mirëfilltë mbi individualizimin e përgjegjësive të tyre penale. Në kushtet kur sasia e lëndës narkotike dhe municioneve të sekuestruara ishte e konsiderueshme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit në kërkesën e tij për gjykim duhet të merrte në analizë elementet e faktit penal, bazuar në rezultatet e hetimit të kryer, i cili tashmë kishte një kualifikim të ri (të ndryshëm dhe lehtësues nga ai i regjistruar) dhe të arsyetonte në mënyrë të qartë përse për të mungonin elementet e bashkëpunimit dhe, pse sipas tij, veprimtaria kriminale e kryer prej B. Q. dhe K. Q. kishte këtë individualizim të përgjegjësive penale, bazuar kjo edhe në analizën e kryer mbi elementet e veprave penale për të cilat po dërgoheshin për gjykim të pandehurit.
43. Edhe në këtë rast, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e palëve lidhur me aktin procedural “Kërkesë për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2013”, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aftësinë e tij profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, sa i takon aspektit të arsyetimit ligjor, vlerësuar në raport me

---

<sup>15</sup>Aktet: procesverbali për marrjen e të dhënave nga K. Q., i datës 20.01.2014, në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet; procesverbali për marrjen e të dhënave nga B. Q., i datës 18.02.2014, në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet; procesverbali i datës 17.11.2013 mbi deklarin e personit ndaj të cilit po zhvillohen hetimet (B. Q.); procesverbali mbi deklarin e personit ndaj të cilit po zhvillohen hetimet (K. Q.); aktet e njoftimit të akuzës të dy të pandehurve etj.

indikatorin e qartësisë dhe kuptueshmërisë së akteve, si dhe cilësisë së analizës në përgatitjen e tyre.

▪ *Lidhur me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2013, për veprën penale “Vjedhja” e parashikuar nga neni 134, pika 1 e Kodit Penal.*

44. Lidhur me kërkesën për gjykimin e këtij procedimi penal, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka pretenduar se si mangësi e pashëruar nga shkaku i ngritur në ankim për këtë çështje penale, mbetet ajo që subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë analizë mbi evidentimin e ekzistencës së të gjithë elementeve të figurës së kësaj vepre penale në veprimet e të pandehurit, e cila sipas tij lidhet ngushtësisht me parashtrimin e faktit penal sikurse parashikon norma procedurale penale e zbatueshme në atë kohë, sipas parashikimeve të nenit 331, pika 2, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale.
45. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar në Kolegj se shtjellimi teorik (doktrinar) i elementeve të figurës së veprës penale nuk është i domosdoshëm në çështje të thjeshta, të qarta në fakt dhe në prova, apo në raste flagrante ku ngjarja është e verifikuar aty për aty, siç pretendoi se është rasti objekt shqyrtimi. Sipas subjektit të rivlerësimit, në këtë çështje bëhet fjalë për një situatë tipike kapjeje në flagrancë të autorit të vjedhjes, ku rrethanat, sipas tij, janë të drejtpërdrejta, të qarta dhe pa asnjë ambiguitet interpretimi dhe se një analizë e gjerë teorike e elementeve të veprës penale nuk do të sillte asnjë vlerë shtesë për drejtimin e çështjes, por përkundrazi do ta zgjaste atë në mënyrë artificiale. Subjekti i rivlerësimit ripërsëriti qëndrimin e tij në lidhje me konfirmimin e akteve nga ana e eprorëve, si dhe lidhur me aftësitë vetëkorrigjuese pas përfundimit të programit 1-vjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës.
46. Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi të ankuesit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi fillimisht se ky procedim penal është një nga pesë çështjet e përzgjedhura me short për vlerësimin e këtij kriteri, sipas parashikimeve të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016. Ky procedim penal është regjistruar prej subjektit të rivlerësimit në ngarkim të shtetasit A. Xh., në vijim të referimit nga Komisariati i Policisë nr. 3 Tiranë, të materialeve hetimore për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Nga analizimi i këtyre akteve, konstatohet se shtetasi i mësipërm është kapur në flagrancë, pasi në afërsi të urës së Tajvanit, i ka vjedhur nga dora aparatin celular shtetasës D. N., send ky që i është gjetur shtetasit A. Xh. në momentin e kapjes, gjatë kontrollit të kryer nga policia.
47. Nga shqyrtimi i dokumentit ligjor “Kërkesë për gjykimin e çështjes”, të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit më datë 18.03.2014, si pretenduar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, evidentuar edhe në raportin e përgatitur nga KLP-ja, konstatohet se pjesa arsyetuese e këtij akti mungon tërësisht. Trupi gjykues vëren se, në kundërshtim me parashikimet e nenit 331, pika 2, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale lidhur me parashtrimin e faktit penal, subjekti i rivlerësimit në këtë kërkesë duket të jetë mjaftuar vetëm në referimin në mënyrë telegrafike të rezultateve të hetimit se shtetasi i cili është arrestuar në flagrancë, ka pranuar se është personi që ka vjedhur

aparatin celular të shtetases D.N.<sup>16</sup>, pa marrë në analizë të mëtejshme faktin penal dhe evidentimin në veprimet e të pandehurit të ekzistencës së të gjitha elementeve të figurës së veprës penale për të cilën ka vendosur të çojë për gjykim këtë procedim penal.

48. Në përfundim, trupi gjykues edhe në këtë rast, pasi mori në shqyrtim pretendimet e palëve lidhur me aktin procedural “Kërkesë për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2013”, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aftësinë e tij profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, sa i takon aspektit të arsytimit ligjor vlerësuar në raport me indikatorin e strukturës së qëndrueshme të akteve, si dhe cilësisë së analizës në përgatitjen e tyre.

▪ *Lidhur me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015, për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, e parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal.*

49. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit në kërkesën për gjykimin e këtij procedimi penal, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes nuk ka bërë argumentim të qartë të rrethanave të faktit dhe veprimeve të të pandehurit dhe lidhjen shkakësore të tyre me pasojën e ardhur, evidentuar kjo, sipas tij, edhe nga vendimi gjyqësor.

50. Në mbështetje të sa më sipër, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme parashitroi se në vendimin gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 02.02.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është disponuar me deklarinimin të pafajshëm të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal, duke arsyetuar, ndër të tjera: *[...] në konkluzionet e prokurorit rreth provave të shqyrtuara në gjykim nuk argumentohet se cilat janë veprimet apo mosveprimet e të pandehurit të kryera nga pakujdesia e që nuk përputhen e vlerësohen me protokollet mjekësore, cilat duhet të ishin masat e duhura që duhet të merrte i pandehuri për të mos ardhur pasoja, cilat ishin veprimet e gabuara të të pandehurit që kanë sjellë pasojën [...] si dhe [...] Lidhur me përdorimin e kësaj metode nuk ka asnjë provë, pasi ky veprim jo vetëm nuk ndodhet i pasqyruar në kartelën klinike, por nuk konfirmohet as edhe nga ndonjë prej personelit mjekësor të pranishëm në lindje [...].*

51. Në kundërshtimin e këtij shkakut ankimi, subjekti ka prapësuar se, pavarësisht vlerësimeve të ndryshme që janë dhënë për këtë ngjarje të cilat, sipas tij, janë pjesë e natyrshme e diskursit profesional, qëndrimi i ankuesit se ai nuk ka arsyetuar shkakun vendimtar të ardhjes së pasojës në aktet procedurale, është i pabazuar. Subjekti pretendoi se ka parashtruar në mënyrë të qartë dhe eksplicite shkakun vendimtar, si në kërkesën për gjykim ashtu dhe në aktin e akuzës dhe në regjistrimin e personit në hetim. Sipas tij, në fjalinë përmbyllëse të arsytimit, ai ka përcaktuar: *Fillesa e pasojës është mosshënimi në kartelë i metodologjisë së përdorur për lindjen nga mjeku N. H., duke mos i pajisur mjekët e tjerë në vijim me dyshimin e nevojshëm mbi dëmtimin e mundshëm të shpretkës.* Sipas subjektit, ky formulim përbën një arsyetim të qartë të elementit objektiv të veprës penale dhe identifikon saktësisht atë që, sipas tij, në doktrinën penale konsiderohet “shkak determinant” i pasojës. Subjekti pretendoi se në tërësinë e ngjarjes, veprimi

<sup>16</sup> *Shih edhe procesverbalin e pyetjes së të akuzuarit, më datë 18.03.2013, në prani të prokurorit të çështjes, ku i pandehuri, shtetasi A. Xh., deklaroi: “Unë deklaroj se këtë vepër penale e kam konsumuar dhe jam penduar [...]”.*

i mjekut shkaktoi çarjen e shpretkës dhe që u komplikua me mosshënimin në kartelë të kësaj metode. Mosplotësimi i kartelës klinike me të dhënat thelbësore të metodologjisë së përdorur gjatë lindjes, në vlerësimin e subjektit, ka përbërë dhe shkeljen protokollare të mjekut H.. Sipas subjektit, nga ky moment është shënuar fillimi i zinxhirit shkakësor, i cili ka krijuar konfuzion mjekësor, vonesë në perceptimin e dëmtimit të shpretkës dhe mungesë të dijenisë së stafit pasues për rrezikun e lindur. Subjekti parashtroi gjithashtu se në këtë çështje, përfundimet mjeko-ligjore nuk mund të kuptoheshin vetëm si akti fillestar i ekspertimit, por si një tërësi provuese e përbërë nga akti dhe deklaratimet e ekspertëve, të cilat së bashku krijuan dy grupe çështjesh: (i) mangësitë në ndjekjen e gjendjes së të ndjerës nga personeli pasues; dhe (ii) shkakun e ngjarjes, dëmtimin e shpretkës nga përdorimi i metodës “Kristeller”. Subjekti parashtroi se, ndodhur në këtë situatë të dyfishtë, ishte detyrimi i tij si organ procedues të përcaktonte shkakun determinant të ngjarjes, detyrim të cilin pretendoi se e ka përmbushur në mënyrë të qartë, duke arritur në përfundimin se mosshënimi nga mjeku H. i metodës së përdorur në kartelën klinike, përbënte shkeljen esenciale të protokollit mjekësor dhe burimin shkakësor të pasojës së rëndë.

52. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se ky procedim penal është hetuar nga Komisioni në kuadër të denoncimit të shtetasit N. H.. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes, në dinamikë të hetimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren si më poshtë.

52.1. Në datën 09.03.2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka regjistruar procedimin penal në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal, në vijim të referimit të marrë nga Komisariati i Policisë nr. 1, se në spitalin “Koço Glozheni” kishte humbur jetën shtetasja M. B.. Në këtë vendim për regjistrim të procedimit penal, në pjesën hyrëse të tij, referohet se është vendosur edhe kryerja e një ekspertimi mjekoligjor, i cili pritet të administrohet.

52.2. Në datën 01.06.2015, rezultoi të jetë përcjellë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore “Akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr. {\*\*\*}”, për shtetasen M. B., i përgatitur nga ekspertët mjeko-ligjor F. S. dhe Z. I.. Nga verifikimi i përmbajtjes së këtij akti, konstatohet se: *[...] në përfundim, ekspertët kanë arritur në konkluzionet se: Në trupin e shtetasës M. B. nuk u konstatuan dëmtime trupore të jashtme si rezultat i ushtrimit të dhunës fizike. [...] Në këqyrjen e brendshme u konstatua grumbullim gjaku në hapësirën e barkut (hemoperitoneum), dëmtim i shpretkës, anemia e organeve. Këto dëmtime (çarja e shpretkës dhe grumbullimi i gjakut në hapësirën e barkut ) janë shkaktuar me mekanizmin e mjetit të fortë mbretës. Shkakun e vdekjes së shtetasës M. B. ka qenë shoku i rëndë traumatik-hemoragjik.* Në konkluzion, ekspertët mjeko-ligjorë kanë arritur në disa përfundime, sipas së cilave referojnë se në rastin e trajtimit mjekësor të shtetasës M. B. vërehen elemente të mjekimit të pakujdesshëm (neglizhencës) të formës së nënvlerësimit me pasojë të drejtpërdrejtë vdekjen e shtetasës M. B.. Mangësitë analizohen në drejtim të ndjekjes së pacientes së ndjerë pas lindjes, nga momenti kur ajo ka shfaqur shenjat e para të gjendjes jo të mirë shëndetësore.

52.3. Në datën 05.06.2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka marrë vendim për delegim kompetencash duke caktuar Oficerin e Policisë Gjyqësore E. B. për të kryer

disa veprime hetimore, ndër to edhe: (i) të pyesë si person nën hetim shtetasen L. B. (mjekja e cila ka ndjekur të ndjerën pas lindjes nga ora 18:00 deri në mëngjes kur ka ndërruar jetë), e cila, sipas përmbajtjes së këtij akti, rezulton të ketë qenë deri në atë moment e dyshuara kryesore dhe e vetme për ngjarjen; (ii) të vijohet me plotësimin e hetimit sipas kërkesës së mjekëve ligjorë [...].

52.4. Në datën 18.06.2015, sipas procesverbalit për marrjen dijëni të të dhënave nga personi që ka dijëni për veprën penale, mjeku ligjor Z. I., teksa është pyetur për të interpretuar fjalët e përdorura në aktin e ekspertimit se: *dëmtimet, çarja e shpretkës dhe grumbullimi i gjakut në hapësirën e barkut janë shkaktuar me mekanizmin e mjetit të fortë mbretës*, ka deklaruar në prezencë të oficerit të policisë gjyqësore dhe prokurorit të çështjes: [...] *Referuar këtyre konkluzioneve, dëmtimi i shpretkës nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë patologjie të mëparshme, por është shkaktuar si pasojë e veprimit traumatik të shtypjes mbi bark nga ana e personelit mjekësor gjatë lindjes, siç mund të jenë edhe metodat e kristeller, e cila përdoret për të ndihmuar nënën për të nxjerrë fëmijën gjatë aktit të lindjes*. Në po të njëjtën datë, sipas procesverbalit për marrjen dijëni të të dhënave nga personi që ka dijëni për veprën penale, mjeku ligjor F. S. ka bërë të njëjtin deklaram në lidhje me interpretimin e shprehjes së cituar në aktin e tyre të ekspertimit, mbi dëmtimin e shpretkës me mjet të fortë “mbretës”.

52.5. Në datën 06.07.2015, subjekti i rivlerësimit ka marrë një tjetër vendim për delegim kompetencash, duke caktuar Oficerin e Policisë Gjyqësore E. B., për të kryer veprimet hetimore: (i) të thirret të paktën një ekspert ligjor që ka bërë aktin dhe kontakti me të të bëhet patjetër në prani të prokurorit; (ii) të thirret mjeku O. G. dhe kontakti me të të bëhet patjetër në prani të prokurorit; (iii) të merret bllok analizash të grave shtatzëna për një periudhë 2 muaj para e pas ngjarjes, ku vëmendja të përqendrohet te hemoglobina dhe eritrocitet; (iii) të tërhiqet i plotë hetimi administrativ i kryer nga stafi drejtues i spitalit dhe Ministria e Shëndetësisë për rastin; (iv) të thirret dhe të njihet mjeku S. C. me përfundimet e ekspertimit mjekoligjor dhe thëniet e mjekëve ligjorë për mënyrën e realizimit të lindjes. Kontakti me të të kryhet në prani të prokurorit.

52.6. Në datën 11.06<sup>17</sup>.2015, në vijim të urdhërimit të prokurorit, është thirrur mjeku ligjor F. S. dhe, në lidhje me këtë veprim hetimor, është mbajtur procesverbali përkatës për deklaramet nga personat që tregojnë rrethana të hetimit. Nga shqyrtimi i këtij procesverbali, konstatohet se mjeku ligjor, në prani edhe të prokurorit të çështjes është pyetur: *Sipas deklaramit të bërë nga ana juaj në datën 18.06.2015, përshkruhet se shkaku i dëmtimit të shpretkës së të ndjerës pacientes M. B. është zbatimi i metodës “Kristeller” për lindjen e fëmijës. Ky përfundim është vetëm një hipotezë apo është një përfundim kategorik për rastin konkret, për të cilin ju keni përpiluar edhe aktin e ekspertimit mjekoligjor përkatës? Në përgjigje të kësaj pyetjeje, mjeku ligjor ka deklaruar: Përfundimi i mësipërm është një përfundim kategorik, nëse pas momentit të lindjes pacientja nuk është goditur me ndonjë mjet apo të jetë rrëzuar diku apo të ketë forma të tjera traumatizimi. Nga materiali që na është vënë në dispozicion, nuk më ka rezultuar të evidentohen trauma të tjera që lidhen me mundësinë e dëmtimit të shpretkës. Kjo nuk rezulton as nga të dhënat e kartelës klinike,*

---

<sup>17</sup> Muaji duket të jetë lapsus.

*as nga deklaratimet e personave që kanë dijeni për ngjarjen. Duke përjashtuar edhe ndonjë patologji të mundshme të shpretkës, të mëparshme, kemi konkluduar se ky dëmtim i shpretkës është bërë gjatë ndihmës që i është dhënë nënës në momentin e nxjerrjes së foshnjës. Po në të njëjtin procesverbal, konstatohet se teksta është pyetur mbi faktin se nëse është përdorur metoda “Kristeller” për lindjen e fëmijës, a është detyrim i personelit mjekësor që ky fakt të përshkruhet në kartelën përkatëse të pacientes, mjeku ligjor është përgjigjur: Çdo veprim mjekësor ose manipulim që bëhet, duhet të shkruhet në kartelën klinike.*

**52.7.** Në datën 30.10.2015, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për regjistrimin e emrit të personit nën hetim, duke regjistruar emrin e mjekut N. H. (mjeku që ka ndjekur lindjen e foshnjës) si person nën hetim për procedimin penal nr. {\*\*\*} të viti 2015, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal. Në po të njëjtën datë subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë aktin për njoftimin e akuzës të pandehurit N. H.. Në këtë akt konstatohet se atribuimi i akuzës mjekut N. H. për kryerjen e veprës penale “Mjekim i pakujdesshëm” parashikuar nga neni 96, paragrafi 1 i Kodit Penal ka ardhur si rrjedhojë e arsytimit të subjektit të rivlerësimit se: *Mjekët nuk kishin parasysh mendimin se lindja mund të bëjë me shtypje nga lart poshtë me bërryl pasi kjo gjë nuk është shënuar në kartelë e për rrjedhojë nuk julindën dyshime apo nevojë për verifikime të shpretkës. Në këto kushte fillesë e pasojës është mosshënimi në kartelë i mënyrës së lindjes nga mjeku N. H., duke mos i pajisur me dyshimin rreth shpretkës mjekët në vijim.*

**52.8.** Në datë 25.11.2015, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për kalimin e çështjes për gjykim dhe ka përgatitur kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes penale nr. {\*\*\*}, të vitit 2015, me të pandehur shtetasin N. H., i akuzuar për konsumim të veprës penale “Mjekim i pakujdesshëm” sipas nenit 96/1 të Kodit Penal. Arsyetimi i prokurorit në këtë kërkesë rezulton të jetë i njëjtë me atë të paraqitur edhe në aktin e njoftimit të akuzës.

**52.9.** Në fashikullin e këtij procedimi penal konstatohet edhe dokumenti *diskutim përfundimtar i shqyrtimit gjyqësor*. Në këtë akt të datës 06.12.2016, subjekti i rivlerësimit në mbështetje të pretendës së tij ka mbajtur këtë qëndrim: *Gjatë zhvillimit të gjyqimit janë thirrur fillimisht mjekët ligjorë të cilët kanë hartuar aktin mjekoligjor përkatës. Ata shpjeguan qartë se në autopsi ishte gjetur gjak në kavitetin e barkut të së ndjerës, çka tregon qartë se ka ndodhur një hemorragji masive. Gjithashtu ata përcaktuan se është evidentuar raptura (çarja) e shpretkës, organ i cili ka formën dhe funksionin e “vazos që mban gjak”, rapturë e cila ka shkaktuar hemorragjinë. Ata shpjeguan qartë gjithashtu se kjo rapturë është shkaktuar nga aplikimi i “Kristeller” që është shtypja mekanike e barkut të nënës me bërryl për të përshpejtuar lindjen, shtypje e cila në disa raste shkakton këtë rapturë të shpretkës. Ata përcaktuan se vetëm kjo gjë e ka shkaktuar rapturën e shpretkës, pasi nga hetimi nuk ka rezultuar asnjë moment kur nëna e ndjerë të ketë rënë nga ndonjë lartësi sado e vogël, apo të ketë episode të goditjes në bark në çfarëdo lloj rrethane. Ata këtë gjë e përsëritën edhe përballë pyetjeve të drejtpërdrejta të vetë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Ata përcaktuan se kjo metodë nuk është e ndaluar të përdoret, por aplikimi i saj duhet të përshkruhet në kartelën e nënës, pasi jo vetëm që kështu e kërkon protokollin formalisht, por shënimi në kartelë mban të sqaruar situatën vijuese për mjekët që vëzhgojnë nënën në vijim.*

53. Në analizë të sa më sipër trupi gjykues vlerësoi se në kuadër të analizës mbi përcaktimin e “shkakut determinant” të pasojës së ardhur, referuar dinamikës së ngjarjeve dhe rezultateve të hetimit të kryer, subjekti i rivlerësimit në aktet e përpiluara prej tij duhet të kishte arsyetuar me qartësi duke argumentuar në mënyrë të strukturuar, rrethanat e faktit dhe veprimet apo mosveprimet konkrete të të pandehurit. Mospasqyrimi me qartësi i shkakut determinant, i pambështetur në rrethanat e faktit (lidhur me përdorimin ose jo nga mjeku të metodës “Kristeller” gjatë lindjes së të ndjerës, znj. B.), sikundër dhe i veprimeve apo mosveprimeve të mjekut H., ka sjellë pasojën e konsiderimit prej subjektit si shkak “determinant”, të një shkakut të cilin gjykata nuk e ka konsideruar si të tillë. Mungesa e argumentimit të sa më sipër nga subjekti i rivlerësimit në qëndrimin e tij si përfaqësuesi i akuzës në gjykimin e kësaj çështjeje, si me të drejtë pretenduar nga ankuesi, rezultoi e evidentuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vendimin e saj nr. {\*\*\*}, datë 02.02.2017, e cila i dha pafajësi mjekut H., në kushtet që sipas gjykatës nuk rezultoi i provuar përdorimi i metodës “Kristeller” gjatë lindjes, për rrjedhojë nuk rezultoi i provuar shkak i konsideruar si “determinant” nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes, për ardhjen e pasojës, humbjes së jetës së të ndjerës znj. B..
54. Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të palëve lidhur me aktin procedural “Kërkesë për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015”, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aftësinë e tij profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, sa i takon aspektit të arsytimit ligjor, vlerësuar në raport me indikatorin e qartësisë dhe kuptueshmërisë së akteve të prokurorit, si dhe të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të akteve të përgatitura prej tij.
- *Lidhur me vendimin për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal me nr. {\*\*\*}, viti 2015, për veprën penale “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal.*
55. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë analizë të nenit 242 të Kodit Penal dhe më pas vlerësimin nëse ekzistonin elemente që konfigurojnë figurën e krimit nga veprimet e kryera nga personi i kallëzuar kundrejt dy punonjësve të policisë së Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë, me cilësinë e kallëzuesit në këtë procedim.
56. Në kundërshtimin e këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar se pretendimi se ai nuk ka arsyetuar se përse nuk është provuar në këtë rast shkelja e nenit 242 të Kodit Penal, bie ndesh me përmbajtjen e vendimit të mosfillimit. Subjekti pretendoi se në vendim ka shprehur qartë se fjalia e përgjithshme e punonjësve të policisë “[...] nuk iu bind urdhrave [...]”, nuk tregon asnjë element objektiv të pengesës së detyrës, për sa kohë sjellja nuk ka kaluar asnjëherë nga refuzimi verbal në akt pengues. Sipas subjektit të rivlerësimit, po të kishim një largim të menjëhershëm me vrap, një zhvendosje që synon shmangien, apo një situatë të mprehtë që ndalon punonjësit të kryejnë detyrën, do të ishte i drejtë një trajtim tjetër i çështjes. Sjellja e punonjësve të policisë në rastin objekt shqyrtimi, sipas subjektit të rivlerësimit, ka qenë qartazi joproporcionale. Subjekti parashitroi se ka vlerësuar edhe ndikimin e sjelljes policore në këtë ngjarje. Sipas subjektit të rivlerësimit në datën 04.11.2015, neni 239 i Kodit Penal (fyerja për shkak të detyrës) ishte

shfuqizuar me ligjin 23/2012. Si pasojë, subjekti pretendoi se çdo fyerje e punonjësve të policisë bëhej çështje krejtësisht private dhe ndiqej prej tyre në gjykatë si persona të dëmtuar dhe, jo si vepër penale e ndjekur nga shteti. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se shoqërimi i shtetasit E. H. në Komisariatin e Policisë nr. 4, vetëm për mungesë dokumenti identifikimi, ishte i pambështetur në ligj dhe cenonte standardin e sjelljes së pritshme nga një polici komunitare. Sipas subjektit të rivlerësimit, kuadri ligjor për shoqërimin dhe kontrollin e identitetit është i qartë dhe nuk parashikon si shkak për shoqërimin fizik drejt Komisarariatit të Policisë nr. 4 rastet e mungesës së mjetit të identifikimit.

57. Subjekti prapësoi se vendimi i mosfillimit nr. {\*\*\*}/2015, është marrë në përputhje me legjislacionin procedural të kohës, është kontrolluar nga drejtuesi dhe zëvendësdrejtuesi i prokurorisë përpara marrjes së formës së prerë, dhe nuk është kundërshtuar nga Policia Gjyqësore sipas urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. {\*\*\*}/2008.
58. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se kjo çështje u përket çështjeve të hetuara nga Komisioni pas riçeljes së hetimit administrativ, sipas vendimit të trupit gjykues të Komisionit të datës 28.04.2022.
59. Nga shqyrtimi i aktit objekt kontrolli, trupi gjykues vëren se vendimi për mosfillimin e procedimit penal i marrë nga subjekti i rivlerësimit në datën 08.12.2015, në lidhje me kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë 09.11.2015, në ngarkim të shtetasit E. H., është bazuar në parashikimet e nenit 59 dhe nenit 290, pika 1, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale. Referuar legjislacionit të kohës, më konkretisht nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, sipas përmbajtjes së tij në datën e marrjes së këtij vendimi, trupi gjykues konstaton se, kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e tij dhe se ky vendim u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.
60. Në vendimin objekt kontrolli, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka marrë në vlerësim kallëzimin penal të shtetasit U. M. dhe faktet e referuara në të, duke verifikuar nëse ato parashikohen nga ligji si vepër penale dhe, në përfundim, ka vendosur të mos fillojë materialin kallëzues nr. {\*\*\*} të vitit 2015, pasi, sipas tij, *në kuptim të nenit 242 të Kodit Penal, faktet e referuara nuk parashikohen si vepër penale nga ligji, ndërsa vepra penale “Fyerje” ndiqet drejtpërdrejt në gjykatë.* Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit këtë konkluzion e ka arritur në mungesë të analizës së nenit 242 të Kodit Penal, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, të lexuar në harmoni me nenin 290, pika 1, shkronja “ç” e po të njëjtit Kod, në të cilin përcaktohet rrethana konkrete, për të cilën nuk lejohet fillimi i procedimit penal. Për më tepër, trupi gjykues vëren se mungesa e kësaj analize duket se mund të ketë sjellë për pasojë edhe mosmarrjen në përgjegjësi penale të personit të kallëzuar, duke orientuar zgjidhjen e saj nëpërmjet paraqitjes së një kërkesëpadie nga pala e dëmtuar në gjykatë. Në përfundim, trupi gjykues, edhe në këtë rast, e gjen të bazuar pretendimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se subjekti i rivlerësimit, përpos kërkesave të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale për marrjen e një vendimi të arsyetuar, nuk ka bërë analizë të nenit 242 të Kodit Penal dhe më pas vlerësimin nëse ekzistonin

elementet që konfigurjnë figurën e krimit nga veprimet e kryera nga personi i kallëzuar kundrejt dy punonjësve të policisë së Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë, me cilësinë e kallëzuesit në këtë procedim.

61. Edhe në këtë rast, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve lidhur me aktin procedural “Vendim për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal me nr. {\*\*\*}, viti 2015”, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aftësinë e tij profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, sa i takon aspektit të arsytimit ligjor, vlerësuar në raport me indikatorin e cilësisë së analizës lidhur me aktet procedurale të përgatitura prej tij.
  - *Lidhur me vendimin për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, për veprën penale “Ndotja e ajrit”, të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal.*
62. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në arsytimin e vendimit që lidhen me ligjin e zbatueshëm për të përcaktuar kufirin e normave të lejuara të lëndëve djegëse që shkarkohen në ajër nga procesi i prodhimit të gëlqeres, për të arritur më pas në përfundimin që për procedimin penal që ka regjistruar, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
63. Në kundërshtimin e këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, përveç prapësimeve për shkaqet e tjera të paraqitura fillimisht në ankim, por të vlerësuara të shëruara në fazën e bisedimeve përfundimtare, ka prapësuar se pretendimi i ankuesit se vendimi i pushimit është marrë pa analizuar legjislacionin mjedisor, është i pabazuar. Sipas subjektit, nga analiza e tij e legjislacionit, ka rezultuar se sjellja e konstatuar nuk plotëson elementet e veprës penale, por hynte në kuadrin e kundërvajtjeve administrative. Neni 60 i ligjit nr. {\*\*\*}/2011, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, e klasifikon kundërvajtjen administrative jo në bazë të niveleve shifrore të shkarkimit të ndotësve në ajër, por në bazë të marrëdhënies që krijon operatori me agjencitë shtetërore dhe detyrimet për regjistrim dhe njoftim të shkarkimeve. Sipas subjektit të rivlerësimit, shtetasi A. D., duke ushtruar një aktivitet të paregjistruar, nuk kishte depozituar informacion në regjistrin e shkarkimeve, sipas nenit 32 të ligjit për ndotjen e mjedisit, duke konsumuar kundërvajtjen administrative të parashikuar në nenin 69/1/a të këtij ligji. Subjekti parashtroi se, nga analizimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. {\*\*\*}/2003 “Për miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër dhe zbatimin e tyre”, tregohet se prodhimi i gëlqeres nuk është automatikisht burim i madh ndotjeje. Sipas tij, ligjvënësi ka përcaktuar nivelet e shkarkimeve të lejuara dhe ka kufizuar qartësisht vetëm përdorimin e materialeve që prodhojnë lëndën ΣC, e cila duhet të jetë 0 në procesin teknologjik të djegies së gëlqeres. Sipas subjektit, goma dhe plastika prodhojnë në çdo rast ΣC, pavarësisht intensitetit të djegies, çka i përjashton automatikisht nga përdorimi. Druri, në të kundërt, nuk prodhon ΣC në nivele që kërkojnë kontroll të posaçëm dhe për këtë arsye nuk figuron si burim ndotjeje në tabelat e këtij vendimi. Sipas subjektit, vetëm përdorimi i gomave dhe plastikës do të passillte përgjegjësi penale.
64. Ky shkak ankimi i përket një prej çështjeve të hetuara nga Komisioni pas riçeljes së hetimit administrativ, sipas vendimit të trupit gjykues të datës 28.04.2022. Nga shqyrtimi i akteve të këtij

fashikulli penal, trupi gjykues vëren se, si pretenduar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, analiza e mësipërme mbi legjislacionin e zbatueshëm në fuqi lidhur me ndotjen mjedisore dhe normat e miratuara për shkarkimet në ajër, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj në shpjegimin dhe justifikimin e vendimmarrjes së tij për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, për veprën penale “Ndotja e ajrit”, të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal, bazuar në parashikimet e nenit 328, pika 1, shkronja “b”, për shkak se *fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale*, nuk rezultoi të jetë përfshirë në vlerësimin e kryer prej tij në aktin procedural të përpiluar në datën 29.06.2015 dhe objekt i këtij shkak ankimi. Në këtë kuptim, pretendimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për mangësi në arsyetimin e vendimit të pushimit të këtij procedimi penal, u gjet i bazuar në fakte.

65. Në vijim të sa më sipër, edhe në këtë rast, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve lidhur me aktin procedural “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014”, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aftësinë e tij profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, sa i takon aspektit të arsyetimit ligjor, vlerësuar në raport me indikatorin e cilësisë së analizës lidhur me aktet procedurale të përgatitura prej tij.
- *Lidhur me kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2016, për veprën penale “Fshehja e të ardhurave” të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.*
66. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë analizën e elementeve të figurës së veprës penale “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, të anës objektive të saj, si dhe as përcaktimin se cilët janë subjektet e kësaj figure krimi.
67. Subjekti i rivlerësimit prapësoi se nuk ekziston asnjë paqartësi në cilësimin juridik, as mungesë e elementeve të figurës së veprës penale dhe asnjë fakt që të tregojë cenim të drejtësisë apo besimit të publikut. Sipas subjektit, ky procedim ka qenë i orientuar drejt, ka rezultuar në shpalljen e fajësisë së autorit dhe ka përmbushur standardet kushtetuese në lidhje me qartësinë e akuzës dhe trajtimin e çështjes në një proces të rregullt. Subjekti pretendoi se, me vendimin e formës së prerë nr. {\*\*\*}, datë 16.02.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehuri K. T. është shpallur fajtor pikërisht sipas nenit 180/1 të Kodit Penal, duke përkrahur në mënyrë të plotë cilësimin juridik të tij dhe, duke konstatuar, se kërkesa për gjykim ishte e qartë, e argumentuar dhe e mbështetur ligjërisht.
68. Në kuadër të shqyrtimit të këtij procedimi penal, pjesë e çështjeve që i përkasin hetimit shtesë të Komisionit, pas riçeljes së hetimit administrativ sipas vendimit të trupit gjykues të datës 28.04.2022, trupi gjykues konstatoi se pretendimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme artikullohet vetëm në drejtim të mungesës së analizës së elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal dhe subjekteve të kësaj vepre, pa ngritur pretendime në drejtim të ndikimit të kësaj mungese në arritjen e një konkluzioni të drejtë lidhur me çështjen, siç parashtrohej fillimisht në ankim dhe siç pretendon edhe subjekti i rivlerësimit.

69. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të këtij procedimi penal konstatohet se edhe në këtë rast, kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim vlerësohet e përciptë, me një përshkrim telegrafik të faktit penal, pa analizë të elementeve të veprës penale dhe anës objektive për të cilën është akuzuar dhe po kërkohet të dërgohet për gjykim çështja penale me të pandehur K. T., në kundërshtim me parashikimet e nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, duke rezultuar për rrjedhojë i bazuar edhe në këtë rast pretendimi i ankuesit objekt shqyrtimi.

70. Në përfundim të analizimit të këtij grupi çështjes penale, trupi gjykues konstatoi se dokumentet procedurale objekt kontrolli, të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit, paraqisnin mangësi të theksuara në drejtim të pjesës arsyetuese të tyre. Në të gjitha rastet e marra në shqyrtim mungonte tërësisht analizimi i elementeve të veprave penale për të cilat akuzoheshin të pandehurit, ndryshe nga sa parashikon neni 331 i Kodit të Procedurës Penale, ndërsa në disa prej tyre u konstatuan problematika edhe në pjesën përshkruese lidhur me parashtrimin e faktit penal dhe rrethanave të tij, si pasojë e mos evidentimit të veprimeve dhe mosveprimeve të të pandehurve të cilat do të merreshin në analizë në raport me anën objektive të veprës për të cilën akuzoheshin.

71. Trupi gjykues konsideroi me peshë të posaçme këtë problematikë në procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2013, të regjistruar për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 283/2 dhe 278, pikat 2 dhe 3 të Kodit Penal, në të cilin u konstatua se kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim, përpos sa më sipër, nuk përmbante as analizën e individualizimit të përgjegjësisë penale për secilin nga të pandehurit. Në vlerësim të trupit gjykues, në këtë rast, duket se subjekti i rivlerësimi në cilësinë e prokurorit të çështjes i ka dërguar për gjykim shtetasit B. Q. dhe K. Q., me pozita të lehtësuara, duke e zhveshur veprimtarinë e tyre kriminale nga forma e bashkëpunimit, e cila për rrjedhojë do të sillte edhe sanksione më të rënda, sipas parashikimeve përkatëse të nenit 283/2 të Kodit Penal. Mungesa e analizës së elementeve të veprës penale në parashtrimin e faktit penal dhe përgjegjësisë individuale penale në këtë rast, por jo vetëm, çmohet nga trupi gjykues se ka qenë një zgjedhje e subjektit të rivlerësimit dhe si e tillë ka përbërë një *modus operandi* të shtrirë në një periudhë të gjatë kohe, në ushtrimin e detyrës së prokurorit.

➤ Lidhur me çështjet penale për të cilat mangësitë e pretenduara kanë të bëjnë me veprime të paplota hetimore të evidentuara si të tilla edhe në vendimet e gjykatave. Në këtë grup përfshihen çështjet penale të mëposhtme, për të cilat trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

▪ *Lidhur me vendimin për mosfillimin e procedimit penal, për kallëzimin penal me nr. {\*\*\*}, viti 2019, për veprën penale “Ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal.*

72. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë veprime hetimore për të verifikuar faktin e pretenduar në kallëzim, pasi duhet t’i jepte përgjigje pretendimeve të ngritura nga kallëzuesi, pavarësisht ecurisë së procesit gjyqësor civil. Sipas ankuesit ky vendim i subjektit i është nënshtruar kontrollit gjyqësor dhe me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.11.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë është disponuar me lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 16.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

73. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në Kolegj se arsyetimi i tij mbetet i pandryshuar dhe në të njëjtën linjë parimore që ka sqaruar për çështjen e kallëzimeve të paraqitura në mes të një procesi gjyqësor kundër ekspertëve. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për këtë rast konkret nuk ekziston asnjë vendim që të rrëzojë arsyetimin e tij juridik ose të konstatojë shkelje procedurale apo materiale që mund të prekë standardin etik. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka pretenduar se vendimmarrja e tij objekt ankimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, vendim i konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.11.2022, të depozituar në cilësinë e provës së re në proces, së bashku me vendimmarrjet e gjykatave që kanë shqyrtuar kallëzimin penal të kallëzuesit E. Ç. edhe ndaj subjektit të rivlerësimit, duke lënë në fuqi vendimin për mosfillimin e procedimit penal ndaj këtij të fundit.
74. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se kjo çështje lidhet me kallëzimin e shtetasit E. Ç., të depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të “Ekspertimit të rremë” ndaj shtetasit E. G., me detyrë eksperte inxhinierë. Kallëzuesi ka qenë palë në një proces gjyqësor civil në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku gjatë procesit gjykata ka caktuar si eksperte shtetasin E. G.. Sipas kallëzuesit, ekspertja nuk ka pasqyruar në mënyrë të drejtë faktet dhe rrethanat objekt ekspertimi dhe për këtë arsye ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale të “Ekspertimit të rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal.
75. Referuar të dhënave të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision<sup>18</sup>, ky kallëzim penal është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako, i cili, me vendimin e datës 31.5.2019, bazuar në nenin 290/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e materialit kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 16.5.2019, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Trupi gjykues konstaton se ndaj këtij vendimi, kallëzuesi ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me anë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 16.10.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit E. Ç., si të pabazuar në ligj në vijim të arsyetimit: *Nga shqyrtimi i akteve dhe pretendimet e palëve në gjykim, gjykata krijoi bindjen se vendimi i mosfillimit, i marrë nga organi i Prokurorisë, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi si një vendim i bazuar në ligj dhe në prova. [...] Gjykata vlerëson se në gjendjen që janë aktet, pretendimet e kërkuarit nuk rezultojnë të kenë elemente të veprimeve apo mosveprimeve penale që duhet të hetohen nga ana e prokurorisë.*
76. Në mungesë të fashikullit të këtij kallëzimi penal për të verifikuar veprimet verifikuese të kryera nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se nga përmbajtja e vendimit të sipërcituar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet e relatuar nga gjykata se: *Nga ana e organit të akuzës, për nevoja të hetimit dhe sqarimit të pretendimeve të kallëzuesit, janë kryer veprimet hetimore verifikuese: është pyetur ekspertja, shtetasja E. G., në lidhje me fazën në të cilën ndodhet*

<sup>18</sup> Konstatohet se nga Komisioni është administruar vetëm vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes për mosfillimin e materialit kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 16.05.2019 dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 16.10.2019, për lënien në fuqi të këtij vendimi dhe, se fashikulli i plotë i këtij procedimi penal nuk ndodhet në dosje.

*gjykimi objekt kallëzimi, e cila ka deklaruar se “Në gjykim e sipër, fazë përgatitore, pa vendim gjykate”.*

77. Ndaj vendimit nr. {\*\*\*}, datë 16.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka ushtruar ankim kallëzuesi E. Ç., duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve. Gjykata e Apelit me anë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 24.11.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 16.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke arsyetuar, ndër të tjera: [...] *Në lidhje me ankimin e paraqitur Gjykata e Apelit Tiranë, çmon se, nuk ka shkak ligjor në pranimin e tij dhe se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka rrëzuar kërkesën ankimore të ankuesit E. Ç., ndaj vendimit të Prokurorit, datë 31.05.2019, për mosfillimin e procedimit penal, në lidhje me kallëzimin nr. {\*\*\*}/2019, është i drejtë, ashtu siç është i bazuar në ligj, në nenin 290, pika 1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale, vendimi i organit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, me të cilin është konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.*
78. Në analizë të sa më sipër, pasi konstatoi se nga kontrolli i ushtruar nga gjykatat e të dy shkallëve, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është gjetur e drejtë dhe e bazuar në fakte dhe nuk rezultoi që në lidhje me këtë çështje, gjykata të ketë evidentuar mungesë të veprimeve verifikuese të materialit kallëzues, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e ngritur nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme lidhur me *vendimin për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal me nr. {\*\*\*}, viti 2019.*
- *Lidhur me kërkesën për pushimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, viti 2017, për veprën penale “Ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal.*
79. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime të plota hetimore për rrethanat e çështjes. Sipas tij, ky vendim i subjektit të rivlerësimit i është nënshtruar kontrollit gjyqësor dhe, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.06.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është disponuar për shfuqizimin e vendimit të pushimit dhe vazhdimin e hetimeve. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2018.
80. Në kundërshtimin e këtij pretendimi të ankuesit, subjekti i rivlerësimit parashtroi se kërkesa për pushimin e procedimit e datës 29.01.2018, si dhe veprimet hetimore të kryera në kuadër të kësaj vendimmarrjeje janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, në vendimin e saj nr. {\*\*\*}, datë 16.02.2021, i cili ka marrë formën e prerë, ka përkrahur përfundimisht kërkesën e Prokurorisë Tiranë për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017. Sipas subjektit të rivlerësimit, në këtë vendim kjo gjykatë ka theksuar në mënyrë të qartë se vetë Gjykata e Lartë ka qartësuar pozicionin juridik të të pandehurve dhe se vendimi i Gjykatës së Lartë është i padiskutueshëm nga prokurori. Subjekti pretendoi se nuk mund të vlerësohet se veprimet hetimore kanë munguar apo kanë qenë të paplota për sa kohë Gjykata e Apelit e ka lidhur pushimin e procedimit penal me vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila e quan të drejtë qëndrimin e ekspertëve të pandehur, duke e konsideruar çështjen të mbyllur në mënyrë të saktë dhe ligjore. Subjekti parashtroi gjithashtu se nga shqyrtimi

i dosjes nr. {\*\*\*}/2017, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk janë evidentuar problematika në shqyrtimin e këtij procedimi, duke u vendosur prej tij arkivimi i çështjes. Në mbështetje të qëndrimit të tij lidhur me këtë rast subjekti ka paraqitur në Kolegj në cilësinë e provave të reja edhe vendimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nr. {\*\*\*}, datë 05.06.2023, që ka pushuar çështjen e ngritur ndaj tij nga kallëzuesja L. P.

81. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, pas verifikimit të akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi se pretendimi i ngritur nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për veprime të paplota hetimore për rrethanat e çështjes, evidentuar si të tilla edhe gjatë kontrollit gjyqësor, duke iu referuar këtu kërkesës së subjektit të rivlerësimit të datës 29.01.2018, për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2017, rezultoi i drejtë dhe i bazuar në fakte.
82. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë se, referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 21.06.2018, të lënë në fuqi nga vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2018, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2017, për veprën penale “Ekspertimi i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, arsyetohet se: *[...] nuk ka pengesë ligjore për kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e Prokurorisë. Nga vlerësimi në tërësi i akteve të ndodhura në fashikullin e hetimeve paraprake, vlerësohet se organi i prokurorisë nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në kuadër të grumbullimit të provave për të vërtetuar faktin penal të pretenduar nga kallëzuesja L. P.. [...] Vetëm pasi të kryhen këto veprime hetimore, thekson gjykata, mund të arrihet në konkluzion nëse në rastin konkret ka apo jo vepër penale.*
83. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kërkesa e datës 29.01.2018, për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2017, dhe veprimet hetimore të kryera në kuadër të kësaj vendimmarrjeje janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila në vendimin e saj nr. {\*\*\*}, datë 16.02.2021, ka përkrahur përfundimisht kërkesën e Prokurorisë Tiranë për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2017, u gjet i pabazuar nga trupi gjykues, duke konfirmuar mungesën e veprimeve hetimore të kryera nga subjekti në këtë çështje. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë se vendimi i sipërcituar i Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ndryshoi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 09.09.2020, duke e ndryshuar atë dhe pranuar kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017, për veprën penale “ekspertim i rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, kishte disponuar mbi kërkesën e datës 10.01.2020, të një tjetër prokurori A. P., kërkesë kjo e cila rezultoi të ishte ridërguar në gjykatë pas kthimit të akteve dhe kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimet e saj nr. {\*\*\*}, datë 21.06.2018 dhe {\*\*\*}, datë 13.05.2019, të lëna në fuqi respektivisht nga vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. {\*\*\*}, datë 10.09.2018 dhe nr. {\*\*\*}, datë 10.07.2019.
84. Në përfundim të sa më sipër, edhe në këtë rast, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve lidhur me aktin procedural “Kërkesë për pushimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, viti 2017”, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aftësinë e tij profesionale, sipas

parashikimit të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, sa i takon aspektit të njohurive ligjore, vlerësuar në raport me aftësinë e tij për të hetuar dhe për të interpretuar ligjin.

- *Lidhur me vendimin për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal me nr. {\*\*\*}, viti 2012, për veprën penale “Ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal.*

85. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë veprime verifikuese për të verifikuar faktin e pretenduar në kallëzim dhe saktësimin e rrethanave të lidhura me aktin e ekspertimit objekt kallëzimi. Sipas tij, ky vendim i është nënshtruar kontrollit gjyqësor dhe, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.07.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është disponuar me shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. {\*\*\*}, datë 10.07.2012, “Për mosfillimin e procedimit penal”, duke e detyruar këtë organ të vazhdojë hetimet.
86. Në kundërshtimin e këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar se edhe në këtë çështje, logjika procedurale dhe juridike është identike me atë të paraqitur në raste të mëparshme që lidhen me kallëzime ndaj ekspertëve. Sipas subjektit të rivlerësimit, zbatimi i këtij standardi nuk është qëndrim personal, por pjesë e një praktike të qëndrueshme dhe të domosdoshme për të shmangur ndërhyrjet artificiale në mes të një procesi gjyqësor. Sipas subjektit, njësoj si në rastet e kallëzimeve ndaj ekspertëve nga shtetasit L. P. dhe E. Ç., përgjegjësia për të vlerësuar saktësinë dhe vlefshmërinë e ekspertimit i përket gjykatës dhe vetëm pasi ky organ të ketë përcaktuar elementin objektiv, mund të shqyrtohet elementi subjektiv i veprës penale. Sipas subjektit, pas prishjes nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.07.2013, të vendimit të datës 24.05.2012, për mosfillimin e materialit kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 10.07.2012, ai ka vijuar hetimet sipas urdhërimit të gjykatës dhe në përfundim ka marrë vendimin e pushimit të këtij procedimi për të njëjtin shkak ligjor “fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”. Sipas subjektit, palët janë njoftuar rregullisht dhe ndaj kësaj vendimmarrje nuk ka pasur asnjë ankim apo kërkesë për prishjen e këtij vendimi.
87. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton fillimisht se procedimi penal nr. {\*\*\*}, datë 29.08.2013, për veprën “Ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, rezulton të jetë një nga 5 aktet e përzgjedhura nëpërmjet shortit për vlerësimin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016.
88. Nga verifikimi i akteve të këtij fashikulli, trupi gjykues konstatoi se, si parashtruar edhe nga subjekti i rivlerësimit, vendimi datë 24.05.2012, për mosfillimin e materialit kallëzues nr. {\*\*\*} të vitit 2012, për shkak se faktet nuk parashikohen nga ligji si vepër penale, është ankimuar nga kallëzuesi A. Rr. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo gjykatë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2012, pasi ka shqyrtuar çështjen, ka vendosur rrëzimin e kërkesës penale nr. {\*\*\*} akti, datë 16.07.2012, si të pabazuar në ligj e në prova, pasi ka arsyetuar se: *Lidhur me sa më sipër, Gjykata vëren se, nga aktet e administruara në fashikullin e kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2012, rezultoi e provuar se, Prokuroria ka analizuar plotësisht veprimet e shtetaseve S. S. dhe A. K., në cilësinë e ekspertëve në një proces gjyqësor civil, të kallëzuara në kallëzimin e depozituar nga shtetasi A. Rr., në lidhje me veprën penale “Ekspertim i Rremë” [...] Organi procedues ka thirrur për të dhënë*

*deklarime shtetasit A. K. dhe A. Rr.; ka administruar kontratën e sipërmarrjes së lidhur mes kallëzuesit A. Rr. dhe shtetasit Rr. G.; ka administruar vendimin nr. {\*\*\*}, datë 25.04.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe aktin e ekspertimit tekniko-kontabël të përpiluar nga ekspertët etj. Nga të dhënat e përfituara nga veprimet procedurale të mësipërme dhe pohimit të ankuesit gjatë gjykimit rezulton se, konkluzioni i arritur nga organi i akuzës, për mosfillimin e hetimeve për kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, viti 2012, për shkak se faktet e kallëzuara nuk parashikohen nga ligji si vepër penale, është rrjedhojë e analizimit të të gjitha fakteve, të vërtetuara gjatë një procesi hetimor të plotë, të gjithanshëm, të drejtë dhe të bazuar në ligjin material dhe procedural penal.*

89. Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ndryshuar nga vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 17.07.2013, duke pranuar kërkesën e ankuesit A. Rr. dhe shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {\*\*\*}, datë 10.07.2012, “Për mosfillimin e procedimit penal”, duke e detyruar këtë organ të vijojë hetimet. Trupi gjykues vëren se Gjykata e Apelit ka arsyetuar: *Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit Tiranë pasi pa aktet që ka fashikulli i gjykimit, konstaton se nga ana e organit të prokurorisë është anashkaluar një fakt shumë i rëndësishëm, që ka të bëjë me veprimet e ekspertëve [...] duke vlerësuar si jo të drejtë vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 09.03.2012, Kolegji Penal çmon se për të pasur një hetim të plotë dhe përfundimtar për zgjidhjen e çështjes, organi i prokurorisë pasi të administrojë dosjen civile (të gjithën) [...] të saktësojë këto rrethana [...].*
90. Mbi bazën e këtij vendimi, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2013 dhe, pasi ka kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Apelit, si parashtruar edhe nga vetë subjekti në Kolegj, ka marrë vendimin datë 03.11.2014, për pushimin e këtij procedimi penal, për të njëjtin shkak ligjor.
91. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi të drejtë dhe të bazuar në fakte pretendimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit lidhur me mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal me nr. {\*\*\*}, viti 2012, për veprën penale “Ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, rezultoi nga kontrolli gjyqësor se nuk ka qenë e bazuar në një hetim të plotë. Përkundër nga sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se në referim të dispozitës së nenit 309 të Kodit Penal që parashikon veprën penale “Ekspertim i rremë”, lexuar në harmoni edhe me nenin 70 të Kodit të Procedurës Penale<sup>19</sup>, ekzistenca e një gjykimi civil në proces nuk mund të përbëjë pengesë për kryerjen e veprimeve hetimore penale në kuadër të kallëzimeve për konsumimin e veprës penale të ekspertimit të rremë, lidhur me aktet e ekspertimit të dhëna para gjykatës civile.

---

<sup>19</sup> Neni 70, “Efektet e vendimit penal për gjykimin civil dhe administrativ”, i Kodit të Procedurës Penale, përcakton: “1. Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm për sa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari.

2. Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër”.

92. Në përfundim, lidhur me aktin procedural “Vendim për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal me nr. {\*\*\*}, viti 2012”, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aftësinë e tij profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, sa i takon aspektit të njohurive ligjore, vlerësuar në raport me aftësinë e tij për të hetuar dhe për të interpretuar ligjin.
- *Lidhur me vendimet për mosfillimin e procedimit penal për disa referime penale me nr. {\*\*\*} të vitit 2013, nr. {\*\*\*} të vitit 2015, nr. {\*\*\*} të vitit 2014, nr. {\*\*\*} të vitit 2016 dhe nr. {\*\*\*} të vitit 2016 për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.*
93. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pretendoi se subjekti i rivlerësimit në këto vendime mosfillimi, pavarësisht sasisë së lëndës narkotike në sasi të vogla, nuk ka kryer veprime të plota hetimore në përputhje me përfundimet unifikuese të vendimit nr. 1, datë 27.03.2008, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me përcaktimin e “dozës së vogël” për “përdorim vetjak” duke mos vendosur kryerjen e ekspertimit toksikologjik përkatës.
94. Në kundërshtimin e shkaqeve të ankimit të ngritura lidhur me çështjet penale në fushën e narkotikëve subjekti ka prapësuar se sa i takon pretendimit të ankuesit lidhur me moskryerjen e veprimeve të plota hetimore në përputhje me përfundimet unifikuese të vendimit nr. 1, datë 27.03.2008, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me përcaktimin e “dozës së vogël” për “përdorim vetjak”, subjekti ka parashtruar se ky pretendim është në parim i drejtë dhe bie dakord me të. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në Prokurorinë e Rrethit Tiranë periudha kohore procedurale pas vendimit nr. 1, datë 27.03.2008, të Gjykatës së Lartë në lidhje me trajtimin e veprës penale të parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal është i ndarë në dy nënperiudha kohore procedurale, para dhe pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale në vitin 2017, i cili futi nocionin procedural të “gjyqtarit të seancës paraprake”. Në kuptim të sa më sipër, në periudhën e viteve 2008-2017, trupa e Prokurorisë së Rrethit Tiranë, sipas subjektit të rivlerësimit, ka përcaktuar se kufiri që do të pranonte se nuk ekzistonte konsumimi i nenit 283 të Kodit Penal për shkak të përdorimit vetjak të lëndëve narkotike, pa u kryer akti ligjor klinikist që buron si detyrim nga vendimi nr. 1, datë 27.03.2008, i Gjykatës së Lartë, do të ishte sasia 3 gr e poshtë, për lëndën *Canabis Sattiva*. Në periudhën pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, ku kërkesat për pushim të procedimeve penale merreshin në shqyrtim nga gjyqtari i seancës paraprake, rezultoi nga praktika se gjyqtarët paraprakë vendosën të kryenin ekspertimin klinikist për të gjitha rastet e konstatuara me *Canabis Sativa*. Sipas subjektit të rivlerësimit, në periudhën deri në vitin 2017, ai ka proceduar me vendime pushimi, pa kryer aktin e ekspertimit klinikist, sipas vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale në vitin 2017, ka proceduar në përputhje me këtë vendim, duke urdhëruar edhe kryerjen e këtij akti ekspertimi. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Kolegj kopje të procedimeve penale të trajtuara prej tij në periudhën 2023-2024, në cilësinë e provës së re në proces. Subjekti i rivlerësimit pretendoi nga Kolegji trajtim sipas parimit të barazisë, pasi për subjekte të tjerë rivlerësimi, të cilët e kanë kaluar procesin e rivlerësimit mungesa e këtij akti ekspertimi klinikist

nuk është vlerësuar penalizues në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, ndonëse ata kanë proceduar direkt me vendime mosfillimi, ndërkohë që rastet e marra në shqyrtim për subjektin e rivlerësimit bëhet fjalë për vendime pushimi të procedimeve penale të regjistruara më parë prej tij.

95. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se edhe çështjet e mësipërme, i përkasin çështjeve të hetuara nga Komisioni pas riçeljes së hetimit administrativ sipas vendimit të trupit gjykues të datës 28.04.2022 dhe se në ndryshim nga sa referuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në aktin e bisedimeve përfundimtare, bëhet fjalë për vendime pushimi të procedimeve penale dhe jo vendime mosfillimi të materialeve kallëzuese.
96. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se nga shqyrtimi i të gjitha procedimeve të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të kundërshtuara nga ankuesi, u konstatua se si pretenduar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit akti klinikist për përcaktimin e “dozës së vogël” për përdorim vetjak, nuk ishte kryer. Subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me orientimet e vendimit unifikues, nr. 1, datë 27.03.2008, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për rrjedhje në zbatim të gabuar të nenit 283 të Kodit Penal, nuk ka kryer në asnjë prej rasteve të verifikuara nga trupi gjykues, aktekspertimin toksikologjik për përcaktimin e “dozës së vogël” për “përdorim vetjak”. Pushimi i këtyre procedimeve penale nga subjekti i rivlerësimit në mungesë të këtij akti ekspertimi, që duhej të realizohej me ndihmën e specialistëve të fushës, ka sjellë përfundime duke u bazuar vetëm në llojin e lëndës narkotike e psikotrope, por jo në cilësitë fiziko-biologjike dhe shkallën e vartësisë nga droga të personit konkret – mbajtës të lëndës narkotike e psikotrope.
97. Moszbatimi i orientimit të dhënë nga vendimmarrja e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me kuptimin dhe zbatimin e nenit 283 të Kodit Penal, u çmua nga trupi gjykues si një shkelje haptazi në kundërshtim me ligjin dhe praktikën gjyqësore unifikuese, e pajustificueshme, ndërkohë që pretendimet e subjektit të rivlerësimit për vendosjen e një praktike institucionale të ndjekur në tërësi nga organi i akuzës (Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë), mbetën në nivel deklarativ.
98. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për trajtim të barabartë me të tjerë subjekte rivlerësi, të cilët e kanë kaluar procesin e rivlerësimit dhe mungesa e këtij akti ekspertimi klinikist nuk është vlerësuar penalizues në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, u gjetën pa peshë në këtë vendimmarrje, për sa kohë trupi gjykues, konkluzionet e tij i bazon në vlerësimin individual të çështjes, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike dhe, jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit.
99. Në përfundim të analizës së kryer, lidhur me shkakun e ankimit mbi vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues pasi mori në shqyrtim, si më sipër, pretendimet e palëve në lidhje me këtë shkak të ankimit vlerësoi se subjekti në mënyrë të përsëritur, ka dëshmuar mangësi në veprimtarinë e tij hetimore, si dhe aktet procedurale të hartuara prej tij kanë mangësi serioze në

disa raste në mungesë të plotë të parashtrimit të rrethanave të faktit dhe analizës për elementet e veprës penale, e në disa të tjera kanë një pasqyrim në mënyrë të përciptë dhe telegrafik të tyre.

100. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se aktet procedurale të përpiluara prej tij kanë qenë brenda standardeve mesatare të praktikës së kohës dhe të konfirmuara si të tilla nga strukturat eprore, u çmuan nga trupi gjykues, si pretendime pa relevancë në analizën e kryer mbi veprimtarinë procedurale të subjektit të rivlerësimit, e cila në çdo rast u bazua në verifikimin e akteve procedurale të përgatitura prej tij, çmuar këto në raport me kërkesat ligjore procedurale të kohës. Në këtë kuptim, përmbushja apo jo e funksioneve kontrolluese nga ana e strukturave eprore ndaj veprimtarisë procedurale të subjektit përveçse jashtë objektit të vlerësimit nga trupi gjykues në këtë rast, u çmua pa peshë në vlerësimin e mësipërm.
101. Trupi gjykues çmoi pa relevancë në analizën e kryer në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit edhe argumentimin e subjektit të rivlerësimit se nga aktet dhe veprimtaria e tij “nuk ka rrjedhur asnjë pasojë serioze, nuk ka pafajësi, nuk ka burgim të padrejtë, nuk ka shpenzim publik të padrejtë, nuk ka lehtësim të papranueshëm të pozitive të të pandehurve”. Trupi gjykues çmoi se veprimtaria e prokurorit, e ushtruar në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave procedurale penale, si një sjellje profesionale e vazhdueshme e tij, dëshmon për një magjistrat që ka mungesë serioze përgjegjshmërie në përmbushjen e detyrës, pavarësisht ardhjes apo jo të pasojave.
102. Lidhur me pretendimin e subjektit, që mangësitë në çështjet e sipërtrajtuara duhen parë të ndërlidhura edhe me numrin e lartë të dosjeve/çështjeve të përmbyllura prej tij në periudhën 2010-2016 dhe në vitin 2024, ndryshe nga sa ai pretendon, trupi gjykues vlerësoi se një numër i lartë çështjesh, nuk përlligj moskryerjen e veprimeve hetimore dhe nxjerrjen e akteve procedurale në kundërshtim me dispozitat procedurale penale, në mënyrë të përsëritur si referuar më sipër në këtë vendim, apo me orientimet e vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë. Përkundër nga sa pretendon subjekti, trupi gjykues analizoi dhe vlerësoi që kjo e dhënë mund të jetë një tregues që, qasja e subjektit në përmbushjen e detyrës së prokurorit ka qenë e orientuar drejt kriterit sasior dhe jo cilësor, pra duke i dhënë më shumë rëndësi mbylljes formalisht të çështjeve, por jo cilësisë në drejtim të kryerjes se veprimeve hetimore, parashtrimit dhe arsytimit të akteve procedurale.
103. Gjithashtu, në konsideratë të kërimit të ankimit të Komisionerit Publik mbi vlerësimin e veprimtarisë profesionale të subjektit të rivlerësimit deri në momentin e marrjes nga Komisioni të vendimit të ndërmjetëm për përcaktimin e detyrimit për ndjekjen e trajnimit 1-vjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për aftësi vetëkorrigjuese, bazuar në aktet e përpiluara prej tij pas përfundimit të programit trajnues dhe të dorëzuara në cilësinë e provave të reja në proces, janë pa peshë në analizën e kryer në kuadër të shqyrtimit të ankimit. Për më tepër, përgatitja e këtyre akteve në kontekstin e një ankimi të Komisionerit Publik, ndaj vendimit të Komisionit për konfirmimin e subjektit në detyrë në pritje për t’u shqyrtuar nga Kolegji, u çmua nga trupi gjykues se nuk krijonte besueshmëri në aftësinë vetëkorrigjuese të subjektit të rivlerësimit.

104. Mangësitë si më sipër konstatuar, u vlerësuan se nuk i atribuoheshin mungesës së njohurive ligjore dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, por ato u paraqiten si një sjellje e vazhdueshme e tij, që demonstroi mungesë të theksuar angazhimi dhe përgjegjshmërie në ushtrimin e funksionit të prokurorit në përputhje me dispozitat procedurale penale. Si të tilla, ato nuk mund të mos vlerësohen për modelin e punës që pasqyrojnë kundrejt rolit, funksionit dhe përgjegjësisë të subjektit si prokuror. Në këtë kuptim, mangësitë e konstatuara nga Komisioni në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 73, paragrafët 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, të konfirmuara edhe gjatë gjykimit në Kolegj, të para bashkërisht e në mënyrë sistematike, tregojnë një zgjedhje e vazhde qasjeje në kryerjen e detyrës, që në vlerësimin e trupit gjykues, nuk mund të korrigjohej përmes programit njëvjeçar të edukimit pranë Shkollës së Magjistraturës, pasi karakterizohej nga sjellje të vullnetshme të subjektit ndër vite.
105. *Lidhur me denoncimin e shtetasit A. L. të depozituar në Kolegj<sup>20</sup> gjatë gjykimit të çështjes*, për të cilin trupi gjykues vendosi të hetojë vetëm lidhur me pretendimet e denoncuesit mbi: (i) moszbatimin nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes të dispozitave procedurale lidhur me njoftimin e përfundimit të hetimeve në çështjen penale me të pandehur denoncuesin, e cila çoi në rrëzimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim nga gjyqtari i seancës paraprake; si dhe (ii) zvarritjen e gjykimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për dërgimin e çështjes në gjykatë, si pasojë e mosparaqitjes së pajustificuar e të qëllimshme të subjektit të rivlerësimit për mbi 14 herë (14 data të caktuara nga gjykata), trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
106. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pretendoi se, në këtë rast, subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale vetëm pas vendimit të gjykatës dhe se, pavarësisht se veprimet procedurale të konstatuara si të pakryera ishin deleguar rregullisht prej subjektit të rivlerësimit dhe një tjetër prokurori, verifikimi për zbatimin dhe kontrollin e veprimeve të Policisë Gjyqësore mbetet përgjegjësi e subjektit të rivlerësimit, si prokurori i çështjes. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pretendoi se subjekti në këtë rast ka treguar mangësi sipas nenit 73, pika 2 e ligjit dhe, për rrjedhojë, sipas tij, ky denoncim duhet të vlerësohet sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësim tërësor të çështjes, sipas kësaj dispozite.
107. Subjekti i rivlerësimit prapësoi se në trajtimin e këtij procedimi penal, ka zbatuar plotësisht sistemin e delegimit. Me anë të urdhrin të delegimit të datës 18.01.2022, subjekti pretendoi se ka përcaktuar qartë njoftimin e aktit të përfundimit të hetimeve dhe të akuzës, por ka dhënë edhe instruksione shteruese mbi detyrimin për t'i bërë me dije të pandehurit afatin 10-ditor për paraqitjen e kërkesave, shpjegimeve dhe kërkesave për veprime hetimore shtesë. Subjekti pretendoi gjithashtu se në vijim, në dy delegimet e datave 14.02.2022 dhe 18.02.2022, ka theksuar shprehimisht se pyetja e të pandehurit duhet të kryhet vetëm në prani të mbrojtësit të zgjedhur prej tij. Subjekti i rivlerësimit prapësoi se, nga analiza e akteve, ka rezultuar se oficeri i policisë

---

<sup>20</sup> Protokolluar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2025, nr. {\*\*\*} prot., datë 19.01.2026 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 22.01.2026.

gjyqësore që kishte marrë përsipër njoftimin ka vepruar sipas praktikës së vjetër të aplikuar para ndryshimeve të legjislacionit procedural penal në vitin 2017. Kjo sjellje, sipas subjektit, nuk buron nga vullneti i tij apo nga udhëzimet e tij të gabuara, por nga perceptimi i tij mbi teknikën e vjetër procedurale. Kjo, sipas tij, është konfirmuar edhe nga konteksti i dosjes dhe nga deklaratimet e palëve në gjykim. Subjekti parashtrroi se sapo është njohur me pretendimin e mbrojtësit të të pandehurit lidhur me sa më sipër, si dhe pasi ka shqyrtuar aktet, i ka kërkuar gjykatës një afat kohor për të shëruar mangësitë procedurale.

108. Lidhur me pretendimin e denoncuesit mbi mungesën e subjektit të rivlerësimit në 14 seanca gjyqësore të caktuara nga Gjykata e Tiranës, ky i fundit prapësoi si të pavërtetë dhe të pambështetur në aktet e administruara në cilësinë e provës këtë pretendim të denoncuesit.

109. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e administruara në cilësinë e provës gjatë gjykimit në Kolegj lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2021, në ngarkim të shtetasit A. L., për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal, konstatoi si më poshtë.

109.1. Subjekti i rivlerësimit ka marrë disa vendime për delegim kompetencash përgjatë hetimit të këtij procedimi penal. Ndër to, me vendimin për delegim kompetencash të datës 18 janar 2022, subjekti i rivlerësimit dhe një tjetër prokurore, S. M., i kanë deleguar oficerit të policisë gjyqësore L. A. kryerjen e veprimeve hetimore: *Të njoftohen zgjatja e afatit hetimor, akti i përfundimit të hetimeve dhe akuza tek A. L., të pyetet si i pandehur dhe të njihet me të drejtën e tij për të marrë 10 ditë kohë për të kërkuar veprime të tjera hetimore.*

109.2. Akti për njoftimin e akuzës që mban datën 18.01.2022 i nënshkruar nga dy prokurorët që kanë ndjekur çështjen rezulton të ketë një shënim “Mora dijëni sot, 22.01.2022” dhe 3 siglime të pakuptueshme se kujt i përkasin, ndërkohë “Njoftimi mbi përfundimin e hetimeve paraprake” i nënshkruar nga prokurorët Gjergji Tako dhe S. M., rezultojnë të mos kenë asnjë shënim. Në fashikull u konstatuan edhe disa procesverbale nga Oficeri i Policisë Gjyqësore L. A., në datat 21.01.2022 dhe 22.01.2022, të përpiluara në kuadër të delegimit të posaçëm për njoftimin e akuzës dhe përfundimin e hetimeve të dy prokurorëve dhe me qëllim për të dokumentuar faktin e njoftimit nëpërmjet telefonit të avokatit të të pandehurit për t’u paraqitur në ambientet e IEVP “Jordan Misja” për të kryer veprimet e deleguara me urdhrin e delegimit të datës 18.01.2022. Nga procesverbali i mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore më datë 22.01.2022, në datën e caktuar për kryerjen e njoftimeve, trupi gjykues konstaton se njoftimi nuk është realizuar si pasojë e mosparaqitjes së avokatit të të pandehurit.

109.3. Më datë 28.02.2022, rezulton të jetë nënshkruar kërkesa për dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. {\*\*\*}/2021, e cila i është përcjellë në vijim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore të mbajtura nga gjyqtari i seancës paraprake, rezulton se në seancën e datës 11.05.2022, nga ana e avokatit të të pandehurit është pretenduar se kërkesa është e pavlefshme për shkak se nuk i është komunikuar përfundimi i hetimeve dhe nuk i është komunikuar akuza. Prokurori, pasi ka marrë kohë të konsultojë dosjen, ka mbajtur qëndrimin e tij se, nga studimi që i ka bërë dosjes, rezulton se nuk ka qenë ky vullneti i tij. Ai është shprehur

se në dosje gjendet urdhri i prokurorit për delegim kompetencash, ku është deleguar njoftimi i akuzës dhe njoftimi i aktit të përfundimit të hetimeve të policia gjyqësore. Nga aktet që ka prodhuar policia gjyqësore, rezulton se në të vërtetë nuk ia ka njoftuar aktin për përfundimin e hetimeve të pandehurit. [...] *gjendur në këtë situatë, mendoj që gjykata duhet të na japë kohë rreth 1 muaj që ky defekt i bindjes së gabuar të oficerit të policisë gjyqësore të riparohet, të njoftohet akti i përfundimit të hetimeve tek i pandehuri dhe ai të paraqesë prova, memorie apo qëndrimin e tij dhe unë më pas si detyrë procedurale të disponoj mbi to.*

**109.4.** Gjykata në vijim ka relatuar: *Në fakt, rezulton se nuk i është komunikuar siç kërkon neni 331, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale në raport me nenin 327 të të njëjtit kod, të pandehurit i njoftohet përfundimi i hetimeve. Sa më sipër, gjykata e konsideron të pavlefshme kërkesën e dërgimit në gjyq, pranon kërkesën e mbrojtësit dhe të pandehurit dhe, sipas nenit 332, germa ç e Kodit të Procedurës Penale, vendos të urdhërojë plotësimin e hetimeve me këtë veprim procedural që nuk është ezauruar, plus dhe të drejtën e të pandehurit dhe avokatit për të paraqitur memorie sipas parashikimeve të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale.*

- 110.** Në analizë të sa më sipër dhe në vlerësim të parashikimeve ligjore të neneve 24, 30, 33, 303 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se përgjegjësia për kontrollin e akteve të fashikullit të dorëzuar gjykatës së bashku me kërkesën për kalimin për gjykim të çështjes, është e prokurorit të çështjes, i cili duhet të kishte konstatuar moszbatimin e urdhrave të tij, për delegimin e disa veprimeve procedurale nga oficeri i policisë gjyqësore. Për më tepër, trupi gjykues, në analizë të aktit të datës 18 janar 2022, gjeti të pakuptimtë që në aktin e njoftimit të akuzës, nga subjekti dhe prokurorja tjetër e çështjes, janë deleguar tek oficeri i policisë gjyqësore, njoftimi në të njëjtën datë si zgjatja e afatit të hetimit dhe përfundimi i hetimeve, si dy veprime procedurale të cilat kurrsesi nuk mund të njoftohen në të njëjtin moment.
- 111.** Në lidhje me pretendimin tjetër të denoncuesit se subjekti i rivlerësimit nuk ishte paraqitur, pa shkak dhe qëllimisht, në seancat gjyqësore të caktuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi 14 herë (14 data të caktuara nga gjykata)<sup>21</sup>, trupi gjykues vëren se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në fazën e bisedimeve përfundimtare, nuk mbajti ndonjë qëndrim lidhur me këtë çështje.
- 112.** Nga verifikimet e kryera nga trupi gjykues në fashikujt penalë të çështjes së administruar gjatë gjykimit në Kolegj nga Prokuroria e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, konstatohet se për këtë procedim penal, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë zhvilluar gjithsej 10 (dhjetë) seanca gjyqësore paraprake, në të cilat Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është përfaqësuar nga prokurorët Gjergji Tako dhe/ose S. M.. Subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë përfaqësuar organin e prokurorisë vetëm në 5 seancat e para gjyqësore, pasi në seancën e gjashtë të zhvilluar në datë 27.06.2022, nga

---

<sup>21</sup> *Shih faqen 14 të denoncimit të shtetasit A. L., datë 08.12.2025.*

gjyqtari paraprak është relatuar se mungesa e prokurorit Gjergji Tako i atribuohet pezullimit të tij nga detyra për shkak të procesit të *vetting*-ut.

113. Trupi gjykues konstatoi se nga 5 seancat gjyqësore në të cilat subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar organin e akuzës, nuk është paraqitur në 3 seanca dhe mosprezenca e tij rezultoi të jetë dokumentuar në procesverbalin përkatës gjyqësor për shkaqe të justifikuara. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i denoncuesit lidhur me këtë çështje, gjendet i pabazuar në fakte.

*C. Mbi vlerësimin e pretendimeve të ankuesit në lidhje me disa gjetje të tjera të evidentuara nga Komisioni gjatë kontrollit të kryer për vlerësimin e kriterit të pasurisë.*

114. *Lidhur me pasurinë e luajtshme, automjet i markës “Mercedes Benz”, me targë origjine {\*\*\*}, Komisioneri Publik pretendoi në ankim se përfundimi i arritur nga Komisioni se: për periudhën nga viti 2012, deri në lidhjen e aktmarrëveshjes (për shitblerje automjeti), të datës 12.10.2016, ky automjet nuk ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe se ai ka provuar që automjeti ka qenë jashtë funksionit, nuk është i bazuar në një vlerësim të drejtë të rrethanave të përdorimit të këtij mjeti. Kjo pasi prokura e posaçme e datës 08.10.2012, nuk rezultoi të jetë revokuar deri në datën 12.10.2016, kur është përpiluar shkresa e thjeshtë për shitje mjeti, duke prezumuar kështu përdorimin e tij nga subjekti i rivlerësimit. Sipas Komisionerit Publik, deklarimet e shtetasit E. A., në deklaratën e datës 21.4.2022, se: disa ditë pas blerjes, automjeti pësoi defekt të rëndë dhe nuk mund të lëvizte, nuk përputhen me aktet e administruara në dosje dhe bien ndesh me prokurën e nënshkruar prej tij në vitin 2012 (4 vite pas blerjes prej tij të automjetit), ku rezultoi se i janë dhënë tagra të plota subjektit të rivlerësimit, përfshirë dhe përdorimin e këtij automjeti për nevoja pune dhe familjare brenda dhe jashtë Shqipërisë. Për rrjedhojë, sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim për rreth 4 vite një automjet pa leje qarkullimi, të përgjithshme në DPSHTRR, si dhe pa paguar detyrimet doganore.*
115. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij para Kolegjit, prapësoi se në lidhje me automjetin e shtetasit E. A., është depozituar në Komision deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 21.04.2022, e këtij shtetasi, i cili ka qenë pronari i mjetit në periudhën në fjalë dhe që konfirmon plotësisht vullnetin, pronësinë dhe detyrimin e tij për zhdoganimin. Më tej, ekziston praktikë e kryer prej tij për zhdoganimin e një mjeti tjetër më datë 07.09.2016, çka tregon në mënyrë të drejtpërdrejtë se përgjegjësia për kryerjen e procedurave doganore i takon atij si bashkëpronar, duke përjashtuar çdo pretendim që KPK-ja ka ngritur ndaj subjektit për atribuimin e një sjelljeje joetike në këtë drejtim. Përderisa pronarët legjitimë të mjetit e kanë përmbushur detyrimin e tyre të zhdoganimit, nuk mund të flitet për asnjë lloj sjelljeje të padrejtë nga ana e tij si përdorues formal ose i pretenduar, çka bën që çdo konkluzion në këtë drejtim të jetë i pabazuar.
116. Në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi si më poshtë.

**116.1.** Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë automjet të tipit “Mercedes-Benz”, me targë origjinë {\*\*\*}, të blerë sipas veprimit juridik të datës 12.10.2016 dhe *plotësisht jashtë funksionit dhe përdorimit*.

**116.2.** Lidhur me këtë automjet, referuar akteve të fashikullit, konstatohet se ai ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë më datë 01.08.2005, vërtetuar kjo sipas “Vërtetim hyrjeje” të lëshuar nga Dogana Durrës. Më datë 15.10.2008, është lidhur një kontratë për shitblerjen e këtij automjeti me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., përpara noterit R. K., nga shitësi B. K. (përfaqësuar me prokurë nga znj. Dh. M.) dhe z. E. A. në cilësinë e blerësit, përkundrejt çmimit prej 5.500 eurosh. Në këtë kontratë përcaktohet se pronësia e mjetit vërtetohet nga: *deklarata e shitjes së mjetit, datë 28.07.2005; librezë e mjetit nr. {\*\*\*}; certifikata e pronësisë nr. {\*\*\*}, vërtetimi i hyrjes nr. {\*\*\*}, datë 01.08.2005 (dokumentacion ky që i përkiste mjetit në vendin e origjinës, përveç vërtetimit të hyrjes së mjetit në Republikën e Shqipërisë)*. Palët kanë përcaktuar në kontratë, ndër të tjera, edhe sa vijon: *Pala blerëse, z. E. A., me njohje dhe mirëbesim të plotë, deklaroi se është dakord të blejë mjetin në kushtet e mësipërme dhe të kryejë të gjitha procedurat e mëtejshme të saj deri në nxjerrjen e targave shqiptare. [...] Automjeti shitet në gjendje të mirë pune e teknike*.

**116.3.** Në datën 08.10.2012, pranë të njëjtit noter, z. R. K., rezultoi të jetë lëshuar një prokurë e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.10.2012, nga E. A., i cili ka deklaruar dhe kërkuar nga noteri sa vijon: *Unë, E. A., jam pronar i një automjeti, lloji “Mercedes Benz”, tipi 140 [...], me targë {\*\*\*}, viti i prodhimit 08.05.1998, karburanti naftë, pronësinë e të cilit e vërtetoj sipas dokumenteve si bashkëlidhur (kontrata e shitjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.10.2008, para meje noterit, certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit të mjetit dhe deklarata e shitblerjes së mjetit). Autorizoj Gjergji Tako, i biri [...] që të administrojë mjetin si më sipër, duke i dhënë të drejtat dhe tagrat si vijon: 1. Të përdorë mjetin në fjalë për nevoja pune dhe familjare, brenda dhe jashtë Shqipërisë, duke ia dorëzuar mjetin si më sipër [...] 2. Të paraqitet para çdo organi administrativ shtetëror për të bërë zhdoganimin e mjetit, si më sipër [...]. 3. Të bëjnë tjetërsimin (shitjen ose dhurimin) e këtij mjeti, vetes së tij apo personave të tretë edhe në bashkëpronësi, duke zgjedhur vetë personin tjetër dhe duke vendosur vetë për kushtet dhe çmimin e shitjes, të nënshkruajë vetë kontratën e tjetërsimit para noterit, si dhe të bëjë pajisjen me targë të këtij automjeti. 4. Të bëjë nxjerrjen jashtë qarkullimit, të nr. të shasisë (asgjësimin për skrap) sipas çmimit që do të gjykojë të arsyeshëm vetë ai. [...] Kjo prokurë është e përvokueshme dhe efektet e saj janë të pakufizuara në kohë*.

**116.4.** Në datën 06.09.2016, nga z. E. A. është depozituar një kërkesë pranë Degës së Doganës Tiranë, me lëndë “Kryerje procedure zhdoganimi”. Ndër të tjera, z. A. shprehet se: *Për arsye të një defekti të rëndë teknik, mjeti më ngeli pa përdorur për një periudhë disavjeçare. Pas riparimit të defektit të mjetit, dua të kryej procedurën e zhdoganimit për të mundësuar lëvizjen e tij [...]. Në vijim, rezultoi të jenë kryer deklaratimet pranë autoriteteve doganore*.

**116.5.** Në datën 12.10.2016, sipas *aktmarrëveshjes [për shitblerje automjeti] (shkresë e thjeshtë)*, konstatohet se z. E. A. në cilësinë e shitësit dhe z. Gjergji Tako në cilësinë e blerësit kanë rënë dakord që z. E. A. t’i shesë subjektin të rivlerësimit *automjetin me targa të origjinës, tashmë të*

çregjistruara {\*\*\*}, me nr. shasie [...] e çregjistruar sipas aktit me certifikatë pronësie me nr. {\*\*\*}, ku përshkruhet shitje për eksportim në datën 11.08.2005 dhe e zhdoganuar pranë autoriteteve shqiptare me deklaratën e zhdoganimit, datë 07.09.2016. [...] Mjeti nuk është në gjendje të pranueshme pune dhe shitet për pjesë këmbimi.

116.6. Në kundërshtimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar një deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.04.2022, të shtetasit E. A., për të cilin shprehet se u qëndron plotësisht thënieve dhe vullnetit të tij. Z. E. A. në këtë deklaratë noteriale të dhënë para noteres E. B., ka deklaruar: *Unë i nënshkruari E. A., deklaroj nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore [...] – Jam kontaktuar nga subjekti i procesit të rivlerësimit, z. Gjergji Tako, i cili më ka kontaktuar dhe më kërkoi që të shprehem në lidhje me automjetin “Mercedes Benz”, tipi [...], me targa {\*\*\*}, i pazhdoganuar, me nr. shasie [...], automjet të cilin unë e kam blerë për nevoja personale dhe nuk kam arritur ta zhdoganoj dhe ta regjistroj në organet përkatëse për shkak se automjeti disa ditë pas blerjes, pësoi një defekt të rëndë dhe nuk mund të lëvizte dot. Jam munduar vazhdimisht për ta rregulluar e nuk e kam rregulluar dot defektin dhe ia kam lënë shtetasit Gjergji Tako me qëllim që ta rregullonte këtë automjet. Meqenëse automjeti ishte me defekt, nuk ishte në gjendje pune, në këto kushte nuk mund të kryhej kontroll fizik dhe regjistrimi i automjetit. Më pas, ky automjet është zhdoganuar nga ana ime. Tagrat e dhëna me prokurën e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.10.2012, nuk u realizuan, përveç dy-tri rasteve kur automjeti ka lëvizur për efekt testimi, për rregullim defekti i cili nuk u rregullua dhe gjendja ka vazhduar njësoj, deri në shitjen përfundimtare për pjesë këmbimi [...].*

117. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren fillimisht se Komisioni, ndonëse ka konstatuar të njëjtat fakte dhe rrethana si më sipër, si me të drejtë evidentuar nga ankuesi, ka arritur në konkluzion se, sipas bindjes së tij të brendshme, automjeti tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, për periudhën nga viti 2012 deri në lidhjen e aktmarrëveshjes (për shitblerje automjeti) të datës 12.10.2016, nuk ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe se ka provuar që ky automjet ka qenë jashtë funksionit. Këtë konkluzion, Komisioni duket ta ketë mbështetur edhe në arsyetimin, sipas tij, se, në kuptim të përmbajtjes së dokumentit “Aktmarrëveshje” [për shitblerje automjeti] të datës 12.10.2016, ku palët në marrëveshje kanë parashikuar se automjeti është i çregjistruar, rrjedhimisht, sipas Komisionit, provohet se subjekti i rivlerësimit ka blerë një automjet jashtë qarkullimit rrugor.

118. Trupi gjykues vëren se Komisioni duket të ketë arritur në konkluzionin se automjeti ka qenë i çregjistruar dhe, rrjedhimisht, jashtë qarkullimit rrugor, duke iu referuar dokumentacionit në vendin e origjinës nga i cili automjeti është çregjistruar për efekt eksporti dhe duke anashkaluar faktin se ky automjet i importuar në Republikën e Shqipërisë, kishte hyrë në qarkullim civil pasi ishte bërë objekt i kontratës së shitblerjes së vitit 2008 dhe prokurës së posaçme të vitit 2012, pa iu nënshtruar detyrimeve ligjore për zhdoganim dhe, rrjedhimisht, as procedurave për regjistrimin e detyrueshëm të tij<sup>22</sup> në regjistrin kombëtar të automjeteve për një periudhë disavjeçare. Detyrime

---

<sup>22</sup> Shih nenin 144 të Kodit Civil, të lexuar në harmoni me nenin 92 të Kodit Rrugor.

ligjore këto të njohura dhe të pranuar nga palët e përfshira në aktet juridike të sipërpërmendura, referuar përmbajtjes së këtyre akteve.

119. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se, sipas prokurës së posaçme, datë 08.10.2012, ushtrimi prej subjektit të rivlerësimit i tagrit të përdorimit të automjetit për nevoja personale apo familjare, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është bërë i mundur me dorëzimin e mjetit nga pronari i ligjshëm te subjekti i rivlerësimit si cituar në këtë prokurë, në të cilën, si me të drejtë pretenduar nga ankuesi, nuk rezultoi të jetë konstatuar ndonjë problematikë teknike e automjetit, si pretenduar nga z. E. A. në deklaratën noteriale të dhënë për nevojat e këtij procesi në vitin 2022. Gjithashtu, konstatohet i drejtë dhe i bazuar pretendimi tjetër i ankuesit se kjo situatë juridike ka qenë prezente për një periudhë 4-vjeçare deri në ndryshimin e statusit juridik të subjektit në raport me automjetin objekt kontrolli (duke u bërë pronar i tij).
120. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se përdorimi pa kufizime i këtij automjeti gjatë kësaj periudhe 4-vjeçare, pa leje qarkullimi në Republikën e Shqipërisë, pa shlyer detyrimet përkatëse për zhdoganimin e automjetit, si dhe përpilimi i akteve të tjera në vitet 2016 dhe 2022<sup>23</sup> me dhe nga shitësi E. A. për qëllime të procesit, e vendos subjektin e rivlerësimit jo vetëm në kushtet e mosrespektimit haptazi e për një periudhë të gjatë kohore të detyrimeve si taksapagues që njëkohësisht paguhet nga buxheti i shtetit, por edhe që dëshmon një sjellje mospërfillëse dhe përpjekje të tij për të shmangur zbatimin e standardeve e detyrimeve ligjore të cilave u nënshtrohen të gjithë qytetarët. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit në kontekstin e cenimit të standardeve të etikës<sup>24</sup>, vlerave themelore të magjistratit<sup>25</sup>, në konsideratë edhe të akteve ndërkombëtare lidhur me trajtimin e këtyre çështjeve<sup>26</sup>, përgjegjësi

---

<sup>23</sup> Referoju paragrafëve 116.5 dhe 116.6 më sipër në vendim.

<sup>24</sup> Shih nenin 4 të ligjit nr. 96/2016, “Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes”, në të cilin përcaktohet:

“1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. 2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit. 3. Në përputhje me parashikimet e këtij neni, Këshillat publikojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. 4. Secili Këshill emëron [...]”.

<sup>25</sup> Në nenin 3 të ligjit nr. 96/2016, “Vlerat themelore”, përcaktohet shprehimisht:

“1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. 2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye. 3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij. 4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa para-gjykime. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi”.

<sup>26</sup> Shih edhe Udhëzuesin Evropian mbi Etikën dhe sjelljen e Prokurorëve Publikë, të miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm të vendeve të Këshillit të Evropës “The Budapest Guidelines”:

thelbësore në garantimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë edhe nëpërmjet zbatimit të ligjit nga vetë magjistratët. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe sjelljen dhe shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision, të konfirmuara edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, që më shumë sesa pranim i fakteve me transparencë, rezultuan në përpjekje për të mënjeluar të vërtetën, edhe nëpërmjet sjelljes së deklaratave noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit që bien ndesh me aktet e kohës<sup>27</sup>.

121. Në lidhje me dy automjetet e tjera, konkretisht automjetin e markës “Mercedes Benz”<sup>28</sup> dhe autoveturën e markës “Volkswagen MH2 Golf”<sup>29</sup>, Komisioneri Publik, në ankim, konfirmoi si të drejta konkluzionet e Komisionit lidhur me vlerësimin e këtyre dy pasurive dhe pretendoi që këto konkluzione të mbahen në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor të procedurave në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar ndryshe nga Komisioni, se subjekti ka cenuar besimin e publikut në atë masë që të bëhet subjekt i parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
122. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij para trupit gjykues në Kolegj, në lidhje me automjetin e markës “Mercedes Benz” pretendoi se është e domosdoshme të bëhet një dallim i qartë midis nocionit të “përdorimit faktik vijues” të automjetit në rrugët publike (përdorimit me intensitet normal të pandërprerë ) dhe situatës kur mjeti nuk i nënshtrohet kuadrit doganor vetëm në aspektin formal, pa u bërë objekt i shfrytëzimit aktual në infrastrukturën publike. Subjekti pretendoi se gjatë hetimit, është provuar se automjeti nuk ka qenë në përdorim të zakonshëm në rrugët publike, por ka qëndruar për periudhën 2-3-mujore në oborrin e shtetasit N. J., dhe se lëvizjet e mjetit kanë qenë sporadike dhe të kufizuara vetëm për nevoja mirëmbajtjeje, pa u shndërruar në qarkullim të përhershëm apo të rregullt. Sipas subjektit të rivlerësimit, për të vlerësuar nëse një sjellje e caktuar arrin nivelin e “shkeljes së rëndë” që diskrediton rëndë figurën e magjistratit, është e nevojshme të konstatohet nëse ajo sjell dëm real të matshëm dhe të ndjeshëm ndaj interesave të shoqërisë ose shtetit. Vetëm shkeljet që prodhojnë një pasojë të tillë materiale apo morale mund të futen në kategorinë e sjelljeve që legjitimojnë masën disiplinore të shkarkimit, vlerësim i cili duhet të jetë proporcional dhe i bazuar në pasojën reale që sjell sjellja e subjektit. Sipas subjektit, sjellja e tij e lidhur me përdorimin e automjetit të pazhdoganuar, nuk ka shkaktuar asnjë dëm, as pasuror dhe as jopasuror ndaj shoqërisë apo shtetit, në një masë që mund të karakterizohej si e “rëndë” në kuptimin kushtetues.
123. Subjekti pranoi se sjellja e tij përbën një shkelje të natyrës formale, e cila ekziston, por nuk ka prodhuar asnjë dëm dhe, si e tillë, hyn qartësisht në kategorinë e shkeljeve më të lehta, të cilat, sipas vendimit nr. 75/2002 të Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të përdoren si bazë për masën

---

<https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>.

<sup>27</sup> Prokura e posaçme e lëshuar në datën 08.10.2012, nga pronari i automjetit në atë kohë, z. E. A., që autorizon subjektin e rivlerësimit të përdorë automjetin brenda dhe jashtë Shqipërisë, për qëllime personale e pune, të kryejë zhdoganime e tjetërsime e veprime të çdo lloji.

<sup>28</sup> Me targë të huaj ES – KB - 5309 e në vijim me targë {\*\*\*}.

<sup>29</sup> Me numër shasie {\*\*\*}.

ekstreme të shkarkimit nga detyra, për sa kohë nuk përmbushin kriterin e shkaktimit të një “dëmi të rëndë” ndaj shoqërisë apo shtetit.

124. Lidhur me automjetin “Volkswagen Golf 2”, subjekti pretendoi se situata është thelbësisht e njëjtë me atë të automjetit të markës “Mercedes Benz”, pasi, sipas tij, edhe ky automjet nuk ka qenë në përdorim të zakonshëm në rrugë publike, por ka qëndruar në një territor jo të asfaltuar, tokë djerrë poshtë banesës së shtetasit S. T., fakt ky, sipas subjektit, i provuar gjatë hetimit administrativ në Komision<sup>30</sup>. Subjekti prapësoi se ai nuk ka qenë përdoruesi efektiv i këtij automjeti, referuar dokumentit përkatës shtetëror nr. {\*\*\*}prot., datë 02.06.2020. Sipas tij, ky fakt heq çdo lidhje të drejtpërdrejtë mes tij dhe pretendimit mbi shfrytëzimin real të mjetit në terren, duke e bërë atribuirimin e sjelljes një çështje thjesht formale dhe jo faktike. Subjekti pretendoi se përdorimi i kufizuar i rastësishëm dhe i lidhur vetëm me lëvizje teknike të mirëmbajtjes, i kryer brenda oborrit dhe hapësirave private për një periudhë të shkurtër kohore, e zhvesh situatën nga çdo element i dëmit faktik që do të rrezikonte funksionimin e rregullt të rendit doganor apo përdorimin e infrastrukturës publike. Në këtë rast, sipas pretendimeve të tij, mungon krejtësisht dimensiononi i ndikimit publik, duke qenë se sjellja është e kufizuar në planin teknik, e dokumentuar, e paqarkulluar në hapësira publike dhe nuk ka sjellë asnjë reagim, pasojë apo perceptim negativ. Për më tepër, veprimet korrigjuese, transparenca dhe sqarimet e menjëhershme të subjektit, sipas këtij të fundit, tregojnë një qëndrim të përgjegjshëm dhe të kujdesshëm që përjashton çdo premisë për cenim të besimit të publikut.
125. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstaton se automjeti i markës “Mercedes Benz” është blerë nga subjekti i rivlerësimit sipas kontratës së shitblerjes së datës 03.03.2005, deklaruar prej tij edhe në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2005, sikundër dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Referuar shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe dokumentacionit të përcjellë bashkëlidhur saj<sup>31</sup> në Komision, rezultoi se ky automjet ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga pika e kalimit kufitar “Tre urat” në datën 17.08.2006, vërtetuar ky fakt sipas dokumentit përkatës, ndërkohë që, sipas komunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit<sup>32</sup>, është përcjellë informacion se, nga verifikimi në sistemin TIMS, ka rezultuar se për të njëjtin automjet, ka një regjistrim në territorin shqiptar në datën 12.12.2004. Mbi bazën e aktit të kalimit të pikës kufitare “Tre urat” në datën 17.08.2006, rezulton të jenë kryer edhe procedurat për shlyerjen e detyrimit doganor në shumën 186.528 lekë, referuar deklaratës doganore të vitit 2006 dhe vërtetimit të zhdoganimit datë 17.8.2006. Në vijim, konstatohet që për këtë automjet të jetë nxjerrë edhe leja e qarkullimit, lëshuar nga organi kompetent më datë 13.11.2006.
126. Në kuadër të verifikimit të kryer lidhur me autoveturën e markës “Volkswagen MH2 Golf”<sup>33</sup>, trupi gjykues konstaton se ky automjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit sipas kontratës së

<sup>30</sup> Referuar deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 11.04.2022, dhe fotografive përkatëse.

<sup>31</sup> Nr. {\*\*\*}, datë 10.11.2021.

<sup>32</sup> Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 14.12.2021.

<sup>33</sup> Me numër shasie {\*\*\*}.

shitblerjes së datës 14.12.2005, deklaruar prej tij ky fakt në deklaratën periodike të interesave privatë të vitit 2005, sikundër dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Nga përmbajtja e kontratës së shitblerjes, konstatohet parashikimi i posaçëm që blerësi ngarkohet me zhdoganimin dhe regjistrimin e mjetit, i cili, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, rezultoi të ketë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë më datë 04.09.2005, i destinuar për qëndrim të përkohshëm. Ky automjet rezultoi të mos jetë regjistruar pranë autoriteteve përkatëse dhe, sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 të Komisionit, automjeti ka kaluar në pronësi të shtetit për shkak mosregjistrimi dhe mosregjistrimi i atribuohet pamundësisë financiare të tij për të shlyer detyrimet përkatëse. Sipas shkresës së Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, automjeti rezultoi të jetë bllokuar më datë 20.10.2010 nga shërbimet e “Njësisë për mbikëqyrjen e autostradave” dhe procesverbali i konstatimit të shkeljes nr. serie {\*\*\*}, datë 20.10.2020, në ngarkim të shtetasit S. T., është plotësuar për mungesë të dokumentacionit të mjetit. Ky automjet, në datën 01.09.2014, rezultoi t’i ketë kaluar Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit.

127. Nga kontrolli i ushtruar përmbajtjes së vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se për automjetin e markës “Volkswagen Golf”, Komisioni ka vlerësuar se: *subjekti i rivlerësimit ka provuar se pavarësisht se i kishte kaluar pronësia me kontratën nr. {\*\*\*}, datë 14.12.2005, nuk ishte përdorues i automjetit tip “Volkswagen golf 2”, por shtetasi S. T., dhe ishte ky i fundit që ka përdorur një automjet pa u pajisur me leje qarkullimi dhe pa shlyer detyrimet doganore [...] Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin për regjistrimin pranë DPSHTRR-së të ndryshimit të pronësisë së automjetit tip “Volkswagen Golf”, mangësi e cila do të vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurisë. Ndërsa lidhur me automjetin e markës “Mercedes Benz”, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *duke marrë në konsideratë parimin e proporcionalitetit, vlerëson se parregullsia e konstatuar në zbatimin e Kodit Rrugor dhe legjislacionit doganor nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si shkak i vetëm që prodhon situatën e cenimit të besimit të publikut [...] regjistrimi me vonesë i automjetit me targë {\*\*\*} pranë DPSHTRR-së do të vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurisë.**
128. Konkluzionet e Komisionit janë gjetur të drejta edhe nga ankuesi dhe nuk rezultojnë të jenë bërë objekt ankimimi nga subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, nga vlerësimi në tërësi i këtyre konkluzioneve, bazuar edhe në sa konstatuar gjatë hetimit administrativ dhe gjatë gjykimit në Kolegj lidhur me këto dy automjete, trupi gjykues çmoi se qasja e subjektit të rivlerësimit në përdorimin e automjeteve, në mosrespektim të detyrimeve ligjore të përcaktuara nga Kodi Rrugor mbi regjistrimin e tyre, si dhe të detyrimeve doganore të përcaktuara nga Kodi Doganor mbi sendet e importuara, nuk është e izoluar, por e përsëritur në kohë. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi mospasjen në përdorim efektiv, të zakonshëm në rrugët publike, automjetet objekt kontrolli dhe nevojën për të bërë një dallim mes nocionit të “përdorimit faktik vijues” të automjetit në rrugët publike dhe situatës kur mjete nuk i nënshtrohet kuadrit doganor vetëm në aspektin formal, pa u bërë objekt i shfrytëzimit aktual në infrastrukturën publike, në vlerësim të legjislacionit të zbatueshëm, u çmuan të pabazuara. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion bazuar në faktin se

detyrimet ligjore të përcaktuara sipas Kodit Doganor në rastet e importit të mallrave dhe ato në fushën e qarkullimit rrugor, referuar këtu parashikimeve eksplicite të nenit 93<sup>34</sup> të Kodit Rrugor, si dhe të pikës 2.25 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 1, datë 30.01.2006, “Për sistemin e taksave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”<sup>35</sup>, nuk përcaktojnë asnjë rezervë apo kufizim në përmbushje, bazuar në faktin e përdorimit apo jo të automjetit. Në këto kushte, edhe pretendimet për mosardhje të pasojës apo mosshkaktim dëmi interesave të shtetit, çmohen pa efekt në justifikimin e një shtete apo sjelljeje të subjektit të rivlerësimit në mospërmbushje të detyrimeve përkatëse ligjore.

129. Gjithashtu, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në raport me këtë sjellje, ku në rastin e automjetit të markës “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, ndonëse automjeti kishte hyrë në Shqipëri në dhjetor 2004, subjekti ka përdorur e sjellë akte sipas të cilave referohet një datë hyrjeje më e vonë (17.08.2006), që favorizonte situatën e tij kundrejt detyrimeve ligjore e financiare në momentin e regjistrimit. Në rastin tjetër, ndonëse automjeti ishte konstatuar në përdorim e qarkullim pa u regjistruar në Shqipëri, në autostradë, nga Policia e Shtetit pas pesë vitesh, subjekti është përpjekur të ndryshojë faktet e t’i paraqesë ato në favor të situatës së tij.
130. Duke konkluduar, mangësitë e konstatuara si më sipër gjatë kontrollit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sjellja e tij e përsëritur për përdorimin e automjeteve në shkelje të legjislacionit në fuqi për qarkullimin e tyre, së bashku me problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit të denoncimit të shtetasit A. L., në lidhje me zbatimin e normave procedurale dhe kontrollin ndaj veprimeve të policisë gjyqësore, dëshmojnë për një funksionar të drejtësisë që ka krijuar një model me mungesë përgjegjshmërie si gjatë dhe jashtë kryerjes së detyrës<sup>36</sup>. Për

---

<sup>34</sup> Në nenin 93 të Kodit Rrugor, me titull “Formalitetet për ndryshimin e pronësisë së automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove dhe për ndryshimin e vendbanimit të pronarit”, përcaktohet shprehimisht:

“1. Në rast ndryshimi pronësie të automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove ose në rastin kur i jepen në përdorim të tjerëve a kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, dega përkatëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga ana e interesuar, brenda 10 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera, si dhe për lëshimin e certifikatës së re të pronësisë.

2. Zyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga pronari brenda afateve të përcaktuara në pikën 1, merr masa për rinovimin ose azhurnimin e lejes së qarkullimit që pasqyron ndryshimet e treguara në pikën e mësipërme. Në mënyrë të ngjashme veprohet edhe për ndryshimin e vendbanimit.

3. Cilido që nuk respekton dispozitat e përcaktuara nga ky nen, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë.

4. Cilido që qarkullon me një mjet, për të cilin nuk është kërkuar, brenda afatit të caktuar në pikat 1 dhe 2, azhurnimi ose rinovimi i lejes së qarkullimit dhe i certifikatës së pronësisë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë.

5. Leja e qarkullimit i merret menjëherë atij që kryen shkeljet e parashikuara në pikën 3 dhe i dërgohet zyrës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që merr masa për rinovimin e saj pas zbatimit të dispozitave që janë shkelur”.

<sup>35</sup> Në pikën 2.18, “Taksa e importimit të automjeteve të përdorura”, të këtij udhëzimi, në kohën e transaksioneve objekt kontrolli, përcaktohej:

“Agjent tatimor për vjeljen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura janë degët e doganës në pikat e kalimit të kufirit. Kjo taksë paguhet nga importuesi i automjetit në momentin e zhdoganimit të tij. Degët e doganës bëjnë llogaritjen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura sipas llojeve të mjeteve [...]”.

<sup>36</sup> <https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>.

rrjedhojë, trupi gjykues i konsideroi ato, në vlerësimin tërësor të tri kritereve, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë në atë masë që të justifikojë zbatimin e parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

131. Në përfundim të gjyqimit, në vijim të konkluzioneve të mësipërme në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe disa gjetjeve të tjera në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në vlerësimin tërësor të kritereve, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, çmohet se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kritereve të procesit të rivlerësimit sipas parashikimit të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, nuk është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 698, datë 15.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 27.02.2026, në Tiranë.

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi –kundër*

#### **KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi –kundër*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtar Sokol Çomo, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për zgjidhjen e çështjes që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 698, datë 15.09.2023, vendim i Kolegjit i cili ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako nga detyra e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë. Bazuar në vlerësimin tim të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.
2. Duke pranuar pjesërisht situatën faktike të konstatuar në vendimin e shumicës së trupit gjykues, do të ndalem në ato fakte dhe rrethana, të cilat, sipas pakicës, meritojnë një vlerësim të ndryshëm, i cili përcakton edhe qëndrimin tim për votën kundër.
3. Subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako u shkarkua nga detyra nga Kolegji, mbështetur në konkluzionet që i përkasin kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, disa gjetjeve të rezultuara në kuadër të kontrollit të kryer lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe nga hetimi mbi një denoncim të publikut të depozituar në Kolegj, duke konkluduar se, në vlerësimin tërësor të tri kriterëve, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në atë masë që të justifikojë zbatimin e parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në vlerësimin e shkakut të ngritur në ankim nga Komisioneri Publik, se subjekti i rivlerësimit nuk e ka kaluar nivelin kualifikues në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për konfirmimin e tij në detyrë dhe se, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke u gjendur në kushtet që mangësitë e evidentuara nuk mund të plotësohen as nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, siç ka vendosur Komisioni me vendimin e ndërmjetëm nr. {\*\*\*} (nr. {\*\*\*} akti), datë 17.06.2022, ndonëse i bashkohem shumicës në kontrollin e ushtruar ndaj gjetjeve të Komisionit objekt i këtij shkakut ankimi, nuk pajtohem me konkluzionin e arritur prej saj se: *mangësitë e konstatuara nga Komisioni në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 73, paragrafët 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, të konfirmuara edhe gjatë gjykimit në Kolegj, të para bashkërisht e në mënyrë sistematike, tregojnë një zgjedhje e vazhde qasjeje në kryerjen e detyrës, që në vlerësimin e trupit gjykues, nuk mund të korrigjohej përmes programit njëvjeçar të edukimit pranë Shkollës së Magjistraturës, pasi karakterizohej nga sjellje të vullnetshme të subjektit ndër vite.*

Analiza në vijim e këtij shkakut ankimi nga pakica, fokusohet në një vlerësim të ndryshëm të situatës faktike të konstatuar nga shumica në vendim, lidhur me çështjet penale objekt verifikimi në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, si më poshtë.

- *Lidhur me çështjet penale për të cilat ankuesi pretendoi se mangësitë e konstatuara kanë të bëjnë me mungesën e analizës ligjore për elementet e kërkuara për të konfiguruar veprën penale:*

4.1. *Lidhur me aktin procedural “Kërkesë për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014”, në vlerësim të elementeve formale të kërkesës për gjykim, referuar përcaktimeve të legjislacionit procedural të kohës, konstatohet se, si me të drejtë pretenduar edhe nga ana e subjektit të rivlerësimit, ligji i kohës kërkonte, ndër të tjera, parashtrimin e faktit penal dhe identifikimin e nenit përkatës të Kodit Penal, ku, sipas akuzës së ngritur, prokurori kishte kualifikuar juridikisht faktin e parashtruar, duke qenë se vetë legjislatori ka përdorur terminologjinë “duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal”<sup>37</sup>. Në vlerësimin e pakicës, ajo që kërkohej nga legjislacioni i kohës, ishte një kërkesë që duhet të përmbante elementet formale të kërkuara në mënyrë të shprehur nga dispozita procedurale, e cila të investonte gjykatën në një proces gjyqësor për të provuar akuzën e ngritur dhe jo një analizë formale të çdo elementi të veprës penale. Për më tepër që kërkesa për gjykim si një akt procedural, referuar parashikimit të nenit 332 të Kodit të Procedurës Penale, shoqërohet me një set të plotë dokumentacioni që përbën edhe fashikullin e gjyqësorit (të krijuar deri në këtë fazë procedurale) dhe nuk mund të vlerësohet e shkëputur prej tyre<sup>38</sup>. Nga shqyrtimi i provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, më konkretisht procesverbalet e seancave gjyqësore të procesit të gjyqësorit në shkallë të parë, nuk u konstatuan në asnjë rast pretendime të ngritura nga palët në drejtim të paqartësisë në lidhje me kualifikimin ligjor të faktit penal dhe akuzës së ngritur, duke mos konstatuar në drejtim të sa më sipër, situata të cilat lidhen me cenimin e së drejtës së palëve në proces, në lidhje me strategjinë e mbrojtjes së tyre ndaj akuzës së ngritur, përpos faktit që kërkesa për gjykim nuk vlerësohet si akti procedural parësor në drejtim të përcaktimit të strategjisë së mbrojtjes, vlerësuar kjo në raport me aktin për njoftimin e akuzës së të pandehurit dhe aktin e përfundimit të hetimeve.*

4.2. *Pakica konstatoi gjithashtu se, sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me qëndrimin e mbrojtësve të të akuzuarve në drejtim të moskundërshtimit të akteve të prokurorit, apo edhe kërkesës së mbrojtësit J. V., për gjykim të shkurtuar të të pandehurit L. P.<sup>39</sup>, provohen nga aktet e administruara në cilësinë e provës, elemente këto që, në vlerësimin tim si gjyqtar në*

---

<sup>37</sup>Shih nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale, i cili në periudhën e dërgimit të kërkesës për gjykim, kishte përmbajtjen si më poshtë:

“1. Kur ka prova të plota për fajësinë e të pandehurit, prokurori paraqet kërkesën për gjykimin e çështjes.

2. Kërkesa për gjykim përmban:

a) gjeneralitetet e të pandehurit dhe të dëmtuarit nga vepra penale;  
b) parashtrimin e faktit, duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal;  
c) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen;  
ç) datën dhe nënshkrimin e prokurorit.

3. Kërkesa u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit”.

<sup>38</sup> Qëndrim ky i mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 27/2024 (JR).

<sup>39</sup> Shiko procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 28.03.2017, ora 10:54:52, faqe 111 e dokumentit nr. 13, dorëzuar bashkëlidhur parashtrimeve të subjektit në Kolegji.

pakicë, duhet të ishin mbajtur në konsideratë nga shumica në drejtim të vlerësimit të efektit të problematikave të konstatuara në ecurinë e procesit gjyqësor penal.

4.3. Nga shqyrtimi i ankimit dhe qëndrimit, në vijim, të ankuesit përgjatë gjykimit në Kolegj, konstatoj se pretendimi i këtij të fundit se, nga kontrolli i bërë nga gjykata, është gjetur si i gabuar cilësimi juridik i bërë nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes, u paraqit për herë të parë në fazën e bisedimeve përfundimtare, duke tejkaluar shkakun e ngritur në ankim, se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, sipas parashikimeve të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, bazuar ky përfundim në gjetjet e Komisionit për të cilat i kishte kaluar edhe barra e provës, se: *(i) kërkesa nuk përmbante elementet e kërkuara nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale; dhe (ii) subjekti i rivlerësimit nuk kishte analizuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzoheshin të pandehurit.*

4.4. Ky pretendim i ankuesit i cili u gjet i bazuar nga shumica, vlerësoj se nuk duhet të ishte bërë pjesë e analizës mbi vlerësimin e gjetjeve lidhur me aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të parashikimit të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se aftësia profesionale e subjekteve vlerësohet pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes. Ky qëndrim i pakicës bazohet në analizën e dispozitave procedurale penale, sipas të cilave në nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet shprehimisht se: *me vendimin përfundimtar, gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose viktima akuzuese [...],* çështje kjo e cila lidhet me shqyrtimin në themel të akuzës së ngritur nga prokurori, e cila mbetet atribut ekskluziv i gjykatës.

4.5. Lidhur me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015, për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, e parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, në analizë të situatës faktike të konstatuar në vendimin e Kolegjit, në paragrafët 52.1 - 52.9, arrij në konkluzionin se pretendimi i ankuesit se subjekti i rivlerësimit, në kërkesën për gjykimin e këtij procedimi penal, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, nuk ka bërë argumentim të qartë të rrethanave të faktit dhe veprimeve të të pandehurit dhe lidhjen shkakësore të tyre me pasojën e ardhur, nuk është i bazuar. Ndonëse mund të ketë diskutime mbi nivelin e elaborimit të elementeve të caktuara të trajtuara në aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të një shtjellimi teorik të analizës mbi “shkakun determinant” të pasojës së ardhur, sa i takon thelbit të arsytimit të subjektit dhe paraqitjes së tij, pakica nuk konstaton paqartësi të atij niveli të cilat të cenojnë kuptueshmërinë e akteve dhe qëndrimeve të prokurorit në dëm të procesit penal. Vlerësimi i subjektit të rivlerësimit dhe arsytimi, sipas bindjes së tij, që e ka çuar atë në përpilimin e kërkesës për gjykimin e çështjes dhe kërkimin nga gjykata të shpalljes së të pandehurit fajtor për veprën penale të “Mjekimit të pakujdesshëm” (pa diskutuar mbi korrektësinë e vlerësimit të subjektit), janë të qartë dhe vijnë në harmoni me hetimin e kryer, logjikisht dhe në dinamikë të këtij procedimi penal, duke treguar, me prezencën e tij në kryerjen e disa veprimeve të rëndësishme hetimore,

përgjegjshmëri dhe angazhim, në përputhje me kërkesat e legjislacionit procedural penal<sup>40</sup>, në funksion të ndjekjes penale.

4.6. Ripërsërit qëndrimin tim kundërshtues me shumicën në drejtim të analizimit të veprimtarisë procedurale të subjektit të rivlerësimit, mbi bazën e qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 02.02.2017, vendimmarrje e cila, në vlerësimin tim, nuk duhet të kishte ndikuar në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, jo vetëm sepse kjo vendimmarrje nuk rezultoi t'i jetë nënshtruar kontrollit nga Gjykata e Apelit, por sepse, në thelb të kësaj vendimmarrje të gjykatës, duket të jetë fakti i të provuarit të përdorimit të metodës “Kristeller”, çka lidhet me themelin e çështjes dhe, në kuptim të parashikimeve të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vlerësimi mbi aftësitë profesionale të subjekteve të rivlerësimit çmohet i ndarë dhe i pandikuar nga korrektësia dhe zgjidhja në themel e çështjes.

➤ *Lidhur me çështjet penale për të cilat mangësitë e pretenduara kanë të bëjnë me veprime të paplota hetimore, të evidentuara si të tilla edhe në vendimet e gjykatave:*

4.7. *Lidhur me kërkesën për pushimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*} të vitit 2017, për veprën penale “Ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, e cila lidhur me pretendimin e ankuesit për veprime të paplota hetimore për rrethanat e çështjes, duke iu referuar këtu kërkesës së subjektit të rivlerësimit të datës 29.01.2018, për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2017, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aftësinë e tij profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, sa i takon aspektin të njohurive ligjore, vlerësuar në raport me aftësinë e tij për të hetuar dhe për të interpretuar ligjin, vlerësoj se ky pretendim nuk duhet të ishte marrë në shqyrtim nga trupi gjykues, si pretendim i ngritur jashtë afateve ligjore, për sa kohë u parashtrua për herë të parë në Kolegj, në fazën e bisedimeve përfundimtare, në tejkallim të shkaqeve të parashtruara fillimisht në ankim<sup>41</sup> lidhur me këtë procedim penal, të cilat adresoheshin në raport me arsyetimin e kërkesës për gjykim dhe jo mungesës së veprimeve hetimore.*

4.8. *Lidhur me vendimin për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal me nr. {\*\*\*}, viti 2012, për veprën penale “Ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, konstatoj se, si evidentuar edhe nga shumica, ky vendim është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.07.2013. Mbi bazën e këtij vendimi, subjekti ka*

---

<sup>40</sup> Shih nenet 24 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale.

<sup>41</sup> Në paragrafin 23.4 të ankimit të Komisionerit Publik, ky i fundit në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2017 ka pretenduar: Komisioneri Publik për sa më sipër vlerëson se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në kërkesën e datës 25.01.2018, për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*}/2017, me arsyetimin se: “vendimi i Gjykatës së Lartë përkrah qëndrimin e ekspertëve” nuk është i bazuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, duke treguar mangësi në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, kriteri i parashikuar në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar. Për më tepër shih parashkrimin e shkakut të ankimit lidhur me këtë procedim penal në paragrafin 23 të ankimit, në faqet 10-11.

regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2013 dhe, pasi ka kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Apelit, ka marrë vendimin, datë 03.11.2014, për pushimin e këtij procedimi penal, për të njëjtin shkak ligjor *se faktet e kallëzuar nuk parashikohen nga ligji si vepër penale*. Procedimi penal nr. {\*\*\*}, datë 29.08.2013, për veprën “Ekspertim i rremë”, i parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, rezulton të jetë një nga 5 aktet e përzgjedhura nëpërmjet shortit për vlerësimin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016. Referuar raportit të vlerësimit, të përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, ky procedim është përzgjedhur në kuadër të vlerësimit të dokumentit ligjor *vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2013”, datë 03.11.2014*, dhe jo të dokumentit ligjor *vendim për mosfillimin e materialit kallëzues nr. {\*\*\*}, viti 2012*<sup>42</sup> – të dyja këto akte rezultojnë të jenë hartuar nga prokurori Gjergji Tako.

4.9. Në vlerësim të kësaj situate faktike, në konsideratë të parashikimit të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit përcaktohet se objekti i punës së institucioneve ndihmëse dhe atyre të rivlerësimit, në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, është rishikimi i dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit dhe të përzgjedhura sipas kësaj dispozite, çmuj se vlerësimi i një dokumenti të ndryshëm nga ai i përzgjedhur sipas procedurës së shortit, është në tejkalim të ligjit. Në vlerësimin tim, çdo akt tjetër i përgatitur nga subjekti i rivlerësimit dhe pjesë e procedimeve penale në të cilat ndodhen dokumentet ligjore objekt kontrolli, sipas kësaj dispozite, duhet të shqyrtohet dhe vlerësohet vetëm në funksion të rishikimit të dokumenteve ligjore objekt kontrolli dhe vlerësimit të gjetjeve lidhur me to, dhe jo të merren në analizë në mënyrë të pavarur, pasi çdo pasojë që mund t’i atribuohet subjektit të rivlerësimit lidhur me to, do të shërbente si premisë për cenimin e vlerësimit të kryer për këtë kriter.

4.10. Pavarësisht sa më sipër, çmuj se veprimtaria e subjektit të rivlerësimit në trajtimin e kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2012, për veprën penale “Ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, në marrjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal për këtë kallëzim dhe regjistrimin e tij, në vijim, sipas urdhërimit të Gjykatës së Apelit, në respektim të urdhërimeve të kësaj të fundit për kryerjen e veprimeve hetimore të caktuara, është rrjedhë normale e procedurës së parashikuar nga neni 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, ku vendimi i mosfillimit të procedimit i nënshtrohet kontrollit dhe vlerësimit të gjykatës, mbi bazën e ankimit të kallëzuesit<sup>43</sup>. Për më tepër, nga verifikimi i dokumentacionit të këtij

---

<sup>42</sup> Në faqen 12 të këtij raporti citohet: “Nga shorti i hedhur, rezulton se u përzgjedhën në mënyrë rastësore 1 (një) vendim mosfillimi, 2 (dy) vendime pushimi dhe 2 (dy) vendime për dërgimin e çështjes për gjykim, dhe se për dosjen nr. 2 që i përket procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 29.03.2013, objekti i shortit është përcaktuar dokumenti ligjor – vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2013, datë 03.11.2014””.

<sup>43</sup> Në Kodin e Procedurës Penale, në nenin 291, “Vendimi për mosfillimin e procedimit”, sipas përmbajtjes së tij në kohën e vlerësimit të fakteve objekt ankimi, përcaktohej se:

“1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

fashikulli, nuk u konstatua asnjë problematikë në drejtim të moszbatimit të urdhërimit të gjykatës.

5. Në përfundim të shqyrtimit të shkakut të ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë: (i) heqjen dorë nga ankuesi mbi pretendimet e ngritura në ankim për 12 çështje penale, për shkak se nga shqyrtimi i tyre nuk u gjetën shkelje procedurale të tilla që mund të çojnë në marrjen e masës disiplinore; (ii) numrin e çështjeve penale për të cilat u konstatuan problematika në drejtim të cilësisë së arsytimit dhe thellësisë së analizës juridike referuar akteve të përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, çmuar kjo në raport me numrin total të çështjeve të kontrolluara nga Komisioni<sup>44</sup>, si dhe numrin total të çështjeve ku konstatimet e shumicës u konfirmuan edhe nga pakica; (iii) faktin që në asnjë nga çështjet penale të marra në analizë, nuk u konstatuan problematika në drejtim të cenimit të të drejtave procedurale të palëve të përfshira në proces, me pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor, apo problematika të cilat mund të orientonin drejt cenimit të interesit publik në drejtim të ushtrimit të funksionit themelor të subjektit si prokuror, atë të ndjekjes penale; (iv) faktin që në pjesën më të madhe të rasteve ku u konstatuan problematika në lidhje me nivelin dhe cilësinë e pjesës arsytuese të akteve procedurale të përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, akuzat ishin pranuar nga të pandehurit/çështjet ishin shqyrtuar sipas procedurës së gjyqimit të shkurtuar; (v) faktin që nga hetimi i thelluar i veprimtarisë procedurale të subjektit të rivlerësimit, rastet e konstatuara nga shumica për mungesë hetimesh, ndonëse të pabazuara në vlerësimin e gjyqtarit në pakicë, rezultuan të papërfillshme në raport me numrin e çështjeve penale të kontrolluara; (vi) ngarkesën në punë të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2010-2016 dhe 2024, e cila rezultoi të kishte qenë mbi dyfishin e mesatares së ngarkesës në punë të prokurorëve të tjerë të së njëjtës prokurori<sup>45</sup>, tregues ky që, i lexuar në harmoni me faktin e moskonstatimit të problematikave në drejtim të shkeljeve të të drejtave procedurale të palëve dhe moscenimit të interesave të shtetit, tregon për një prokuror i cili ka menaxhuar me efektivitet procedimet penale të caktuara për trajtim – arrij në përfundimin që problematikat e evidentuara në drejtim të cilësisë së akteve procedurale të përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, janë të tilla që mund të korrigjoheshin, sikundër dhe rezultuan gjatë gjyqimit të çështjes në Kolegj<sup>46</sup>, nga programi trajnues i Shkollës së Magjistraturës.

6. Fakti që nga kontrolli i ushtruar edhe në Kolegj, nuk rezultoi në asnjë rast që praktika e ndjekur nga subjekti i rivlerësimit të ishte bërë objekt diskutimi/vërejtje nga strukturat eprore, çmoj

---

2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit”.

<sup>44</sup> Referuar këtu edhe çështjeve penale të kontrolluara sipas vendimeve të trupit gjykues të Komisionit për riçeljen e hetimit administrativ të datës 28.04.2022 dhe të datës 04.05.2022, përpos çështjeve të shqyrtuara sipas parashikimeve të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe çështjeve të tjera të verifikuara në kuadër të burimeve arkivore apo edhe denoncimeve nga publiku.

<sup>45</sup> Shih shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. {\*\*\*} prot., datë 04.12.2025.

<sup>46</sup> Referuar këtu akteve të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit pas përfundimit të programit 1-vjeçar të Shkollës së Magjistraturës, të dorëzuara prej këtij të fundit në Kolegj, në cilësinë e provave të reja në proces.

se duhet të ishte mbajtur në konsideratë nga shumica, jo vetëm si një formë pranimi e praktikës së ndjekur në formulimin e akteve nga subjekti i rivlerësimit në kontekst të parashikimeve ligjore të kohës mbi mënyrën e organizimit të prokurorisë si një organ i centralizuar dhe funksioneve të prokurorit më të lartë në lidhje veprimtarinë e prokurorit të çështjes, por edhe në drejtim të mundesës së një qëndrimi mosreflektues ndaj vërejtjeve të eprorëve. Si rrjedhojë e sa më sipër, e gjej të pabazuar konkluzionin e shumicës se kjo ka qenë një qasje në kryerjen e detyrës që karakterizohet nga sjellje të vullnetshme të subjektit ndër vite dhe, si e tillë, nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

7. Sa i takon denoncimit të shtetasit A. L., të depozituar në Kolegj, i qëndroj konkluzionit të shumicës mbi përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit në kontrollin e veprimtarisë së policisë gjyqësore, pavarësisht delegimit të rregullt për kryerjen e disa veprimeve hetimore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

8. Duke u shprehur dakord edhe me qëndrimet e mbajtura nga shumica në lidhje me çështjen e përdorimit nga subjekti të automjeteve në kushtet e mosrespektimit të legjislacionit në fuqi për regjistrimin dhe shlyerjen e detyrimeve doganore përkatëse, sjelljen e të cilit e vlerësoj të papërputhshme me etikën e një prokurori, çmoj se këto konkluzione, së bashku me problematikën e rezultuar nga hetimi i një denoncimi në lidhje me mosrespektimin e së drejtës procedurale të të pandehurit për t'u njohur me aktin e përfundimit të hetimit, i cili rezultoi një episod i izoluar, të vlerësuara sipas parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk janë të tilla që të mund të justifikojnë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, si pasojë e zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë të sa më sipër analizuar, në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, shkarkimi i subjektit të rivlerësimit nga detyra nuk gjendet i drejtë.

9. Për të gjitha sa trajtuar më lart, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako.

**GJYQTAR**

**Sokol ÇOMO**

*Nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, për lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako. Kam ndarë të njëjtin qëndrim me atë të gjyqtarit tjetër në pakicë Sokol Çomo, lidhur me problematikat që i adresohen kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe etikës së magjistratit, ndërsa kam pasur një qëndrim të ndryshëm me gjyqtarin në pakicë, për sa i përket trajtimit të shkakut të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Në këto kushte, arsyetimi im në vijim do të shtjellojë vetëm këtë qëndrim të ndryshëm, duke iu bashkuar mendimit tjetër në pakicë, për çështjet e tjera të trajtuara në të.
2. Nga ankimi i Komisionerit Publik, lidhur me shkaqet që i adresohen kriterit të aftësive profesionale, konstatohet se ato ndonëse janë përdorur si shkaqe për të kundërshtuar vendimin e Komisionit që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, në fakt kontestojnë drejtpërdrejt vendimin e ndërmjetëm të marrë nga Komisioni me nr. 9, datë 17.06.2022, me anë të të cilit është vendosur pezullimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit dhe detyrimi i tij për të ndjekur programin njëvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, vendim i cili, në zbatim të parashikimeve kushtetuese të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk është një vendim i ankimueshëm.
3. *Së pari*, konstatohet se ankimi lidhur me këtë kriter kundërshton konkluzionet e Komisionit të arritura për të njëjtat çështje të hetuara prej subjektit të rivlerësimit, të cilat janë marrë në analizë prej Komisionit në vendimin e tij të ndërmjetëm, të lartcituat, të marrë për shkak të mangësive të konstatuara në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të tij. Ankimi dhe konkluzionet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ftojnë trupin gjykues të bëjë një analizë dhe vlerësim të ndryshëm të mangësive të konstatuara në hetimin e disa prej çështjeve, nga ai i bërë prej Komisionit, përpara se ndaj subjektit të vendosej masa disiplinore e pezullimit, vlerësim i cili është mbështetur prej shumicës së trupit gjykues.
4. Sipas mendimit tim, të mbajtur edhe në çështje të ngjashme të mëparshme<sup>47</sup>, në kushtet kur, referuar akteve të administruara në dosje, rezulton se subjekti ka ndjekur programin e trajnimit, bazuar në kurrikulat e Shkollës së Magjistraturës dhe nuk ka pasur ndonjë kontestim për mënyrën se si ai është vlerësuar në përfundim të programit, për nivelin e tezës që i është dashur të zgjidhë në provimin përfundimtar ose për çdo lloj rrethane që do të kishte vënë në diskutim vijueshmërinë e ndjekjes së programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës apo rezultatin e provimit të përfundimit, në një prej formave që sugjeron zbatimin i nenit 60 të ligjit nr. 84/2016<sup>48</sup>, shërimi i

---

<sup>47</sup> *Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 46, datë 27.10.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, mendimi i pakicës, si dhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 9, datë 09.02.2026, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, mendimi paralel.*

<sup>48</sup> *Neni 60 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: "1. Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhë 1-vjeçare i jepet subjektit të rivlerësimit nëse janë evidentuar mangësi në aftësitë e tij profesionale që mund të plotësohen. 2. Në rast se subjekti i rivlerësimit përfundon programin e trajnimit, Shkolla e Magjistraturës i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë rezultatet e provimit përfundimtar,*

problematikave nëpërmjet këtij programi, prezumohet ligjërisht i realizuar dhe nuk mund të jetë objekt kontrolli i mëtejshëm prej Kolegjit.

5. Nëse në ankimin e Komisionerit Publik do të ishin evidentuar rrethana që lidheshin me zbatimin e kësaj dispozite, situata faktike nuk do të ishte e njëjtë me atë të vlerësuar prej Komisionit në marrjen e vendimit të ndërmjetëm dhe vendimi i konfirmimit do të duhej të kontrollohej për këto elemente të rija të dala rishtas, e të pavlerësuara me vendimin e konfirmimit në detyrë.
6. Përderisa nuk gjendemi para një situatë të tillë, pra, pa një lëndë të re e të patrajtuar në vendimin e ndërmjetëm për pezullim nga detyra, në vijim, qëndrimin tim e mbështes në konstatimin se e gjithë analiza, në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit në drejtim të këtij kriteri, do të mbështetej mbi të njëjtat fakte, për të cilat është marrë vendimi i ndërmjetëm i Komisionit për pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe dërgimin në Shkollën e Magjistraturës.
7. Në këto kushte, kam vlerësuar se ankimi i Komisionerit Publik, por edhe qëndrimi i mbajtur prej Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare, ndonëse jo për të gjitha çështjet e analizuar në ankim, që *a prima facie* ankimon vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, konteston në fakt, për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vendimin e ndërmjetëm të Komisionit për pezullimin nga detyra dhe dërgimin e subjektit në Shkollën e Magjistraturës. Komisioneri Publik, duke mos qenë dakord me arsyetimin dhe vlerësimin e Komisionit se mangësitë mund të korrigjohen nëpërmjet trajnimit njëvjeçar, dhe në mungesë të së drejtës për të ankimuar drejtpërdrejt vendimin e ndërmjetëm për shkak të ndalimit të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, ka përdorur të drejtën e tij për të kundërshtuar në tërësi vendimin e konfirmimit të subjektit, nëpërmjet kontestimit të tërthortë të vendimit të ndërmjetëm. Shkaqet e ankimit të ngritura në ankimin objekt gjykimi, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, i adresohen tërësisht problematikës së analizuar në kuadër të vendimit të ndërmjetëm për dërgimin në shkollën e Magjistraturës, të cilat, sipas ankimit, duhej të kishin çuar Komisionin, krahas problematikave të tjera lidhur me pasurinë dhe etikën, në marrjen e një vendimi shkarkimi dhe jo pezullimi.
8. Në ankimin objekt gjykimi, nuk rezulton të jetë prezantuar asnjë fakt që lidhet me hapat apo ngjarjet e ndodhura pas marrjes së vendimit për dërgimin në Shkollën e Magjistraturës, të cilat mund të kishin bërë të atakueshëm vendimin për konfirmim të subjektit, përtej çështjeve të analizuar në vendimin e ndërmjetëm, siç mund të ishin kurrikulat e papërshtatshme, problematika me nivelin e kalimit të provimit përfundimtar të kryer në kuadër të programit të trajnimit, sipas nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, apo gjetje e kontestime të bëra prezente prej vëzhguesve ndërkombëtarë, që lidhen me trajnimin apo provimin përfundimtar dhe vlerësimin e arritur në fund të tij. Të tilla kontestime mund të adresoheshin ndaj vendimit të Komisionit për konfirmimin edhe

---

*duke u shprehur nëse mangësitë janë mënjeluar ose jo. 3. Komisioni njofton subjektin e rivlerësimit brenda 10 ditëve të paraqesë një shpjegim me shkrim mbi arsyet e mospërfundimit me rezultate të kënaqshme të programit të trajnimit gjatë periudhës së pezullimit. Një kopje e këtij njoftimi i dërgohet vëzhguesit ndërkombëtar”.*

nëse rezultati i provimit nuk do të ishte vlerësuar si i kënaqshëm prej Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës.

9. Në këto kushte, kam vlerësuar se, në vijim të konkluzioneve për çështjet e këtij kriteri, në këndvështrim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, ndaj këtij vendimi të Komisionit, nuk mund të ushtrohet kontroll nëpërmjet ankimit, qoftë i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, për arsytet e renditura si më poshtë.

9.1. Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji, subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra, sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit.*

9.2. Ndërsa neni E, paragrafi 2 i Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim, identifikon mangësitë. Gjatë periudhës së pezullimit, të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj. Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë. Në fund të programit, ai testohet për aftësitë e tij. Ky testim mbikëqyret nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Subjekti i rivlerësimit që nuk e kalon testimin, shkarkohet nga Komisioni.*

9.3. Në një lexim harmonik të këtyre parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës, arrihet në konkluzionin se vendimi i Komisionit për pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe urdhërimin për ndjekje të programit njëvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, është një vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit e për të cilin Kolegji nuk gëzon juridiksion *ratione materiae*.

9.4. Neni E, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se Komisioni merr një vendim të tillë: *Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Kjo dispozitë kushtetuese është transpozuar edhe në nenin 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: *Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë: b) “Me mangësi”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv. Komisioni ka rekomanduar program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës për të plotësuar këto mangësi brenda një viti.**

9.5. Sipas një interpretimi sistematik dhe teleologjik të këtyre dispozitave, në vlerësimin tim, rezulton se ligjvënësi ka njohur diskrecionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit deri në konstatimin e mangësive dhe mundësisë për shërim nga trajnimi njëvjeçar. Ky vlerësim duket se vjen në mënyrë parësore prej Komisionit dhe konfirmohet *ipso lege* si i tillë, duke ia lënë peshën e kësaj vendimmarrjeje në

mënyrë të plotë dhe përfundimtare këtij organi, që kryen edhe vlerësimin profesional, në zbatim të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

9.6. Përjashtimi që bën neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës për të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi, lexohet si qëllim i ligjvënësit për të mos lejuar kontrollin mbi të, në mënyrë përjashtimore dhe të shprehur. Ky përcaktim kushtetues nuk lejon as ankimin e tij me vendimin përfundimtar, siç është ai i konfirmimit, pasi, parashikimi kushtetues nuk ndalon vetëm ankimin e veçantë ndaj këtij vendimi, por nuk lejon ankim ndaj tij në asnjë stad/fazë të procesit të rivlerësimit, duke i dhënë atij formë të prerë me ligj, dhe madje duke sugjeruar edhe ekzekutimin e tij të menjëhershëm.

9.7. Në këtë kuptim, çështjet e analizuara në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, e për të cilat Komisioni, si organi kompetent, ka urdhëruar pezullimin dhe dërgimin në Shkollën e Magjistraturës, nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për shkak të ankimit të një prej palëve, por as të vlerësohen prej tij në mënyrë incidentale, për sa kohë që Kolegji shqyrton çështjet si një gjykatë apeli, brenda kufijve të shkaqeve të ankimit, parim i cili është konservuar e zbatuar me rigorozitet nga jurisprudenca e Kolegjit në vite.

9.8. Duke e konsideruar këtë vendim si një vendim të formës së prerë, edhe në këndvështrim të përcaktimeve procedurale të përgjithshme të parashikuara nga neni 451, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile<sup>49</sup>, arsyet apo konkluzionet e arritura në të nuk mund të jenë më objekt i kontrollit gjyqësor as nga një gjykatë më e lartë, siç është Kolegji, sepse përndryshe do të gjendeshim para cenimit të parimit *ne bis in idem*, qoftë ky kontroll edhe në funksion të shqyrtimit të një ankimi të tërthortë apo të maskuar ndaj tij.

10. Për sa më lart, në vlerësimin tim, problematikat e ngritura në ankim që i adresoheshin kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, nuk mund të ishin objekt shqyrtimi në Kolegj e, për këtë pjesë të ankimit, konfirmohen *ipso lege* konkluzionet e Komisionit në vendimin e konfirmimit.
11. Në këto kushte, të vetmet problematika që mbeteshin për t'u vlerësuar prej trupit gjykues, në vlerësimin tim, ishin ato që lidheshin me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe çështjet e etikës, për të cilat kam ndarë të njëjtin qëndrim me atë mbajtur në mendimin tjetër në pakicë, duke mos i konsideruar se janë të mjaftueshme të ngrihen në nivelin e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

## GJYQTARE

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

---

<sup>49</sup> *Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur: “(a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij”.*